




MITROVICA
KOMPANIA UJESJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 13.03.26 Nr.: 01-727



Raporti Vjetor i Performancës- së KRUM-së për Vitin 2025

Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 13.03.2026, me Nr. 03/2026, pas shqyrtimit të Raportit Vjetor 2025 mbi zhvillimet dhe aktivitetet afariste në Kompani, miratoi Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2025.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv: Bashkim Kurti	Kryesuese e BID-së: Kumrije Kelmendi Aliu
Nënshkrimi		
Data	13.03.2026	13.03.2026

KOMPANIA RAJONAL UJËSJELLËSI "MITROVICA" Sh. A.




MITROVICA

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

RAPORT VJETOR

2025



Mitrovicë, 2026

TABELA E PËRMBAJTJES

1	RAPORTI I KRYESUESSES SË BORDIT.....	4
	Te nderuar,	4
	Sfidat dhe prioritetet përpara	4
	Shikimi drejt së ardhmes.....	4
1.1	Aktivitetet dhe performanca e KRU "Mitrovica".....	6
1.2	Të dhënat mbi drejtorët jo-ekzekutiv	6
2	RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV	10
2.1	Hyrje	10
2.2	Ngjarjet kryesore të vitit.....	10
2.3	Përfundim.....	11
2.4	Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës	12
2.5	SHËRBIMI TEKNIK	24
2.6	PLANIFIKIMI & ZHVILLIMI	31
	Gjatë vitit 2025 është intensifikuar puna rreth digjitalizimit të rrjetit të ujit dhe kanalizimit, si dhe konsumatorve.....	31
2.7	SHËRBIMI KOMERCIAL.....	35
2.8	INFORMIMI I KONSUMATORËVE.....	39
2.9	PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE.....	41
2.10	RAPORT I SHËRBIMIT ADMINISTRATIV & BURIMEVE Njerezore	43
2.11	AKTIVITETET E PROKURIMIT.....	48
2.12	PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEM	50
3	SHTOJCA: Pasqyrat financiare.....	53

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Bordi i Drejtorëve jo – ekzekutiv	7
Tabela 2. Komisioni i Auditimit	7
Tabela 3. Aprovimi i Rregulloreve/Planeve/Raporteve për periudhën 2025 nga Bordi i Drejtorëve	8
Tabela 4. Paga bazë për Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin e Auditimit gjatë vitit 2025.....	9
Tabela 5. Mitrovicë – Indikatorët kyç të performancës.....	12
Tabela 6. Vushtrri – Indikatorët kyç të performancës.....	14
Tabela 7. Skenderaj - Indikatorët kyç të performancës	16
Tabela 8. KRU "Mitrovica"- Indikatorët kyç të performancës (pa veriun e Zveçanin).....	17
Tabela 9. Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani - Indikatorët kyç të performancës	18
Tabela 10. KRU "Mitrovica" - Indikatorët kyç të performancës	19

Tabela 11. Krahasimi i indikatorëve kyç me Plan të Biznesit.....	20
Tabela 12. Inkasimi	21
Tabela 13. Inkasimi në euro dhe përqindje sipas kategorive	21
Tabela 14. Shpenzimet vjetore 2023 -2025	22
Tabela 15. Shpenzimet në euro dhe përqindje pa borxhin e keq	24
Tabela 16. Distribrimi i ujit sipas ITU-ve	26
Tabela 17. Krahasimi i furnizimit sipas viteve	27
Tabela 18. Sasia e kimikateve të shpenzuara.....	28
Tabela 19. Shpërndarja sipas njësive operative	29
Tabela 20. Kërkesat gjatë vitit 2025.....	31
Tabela 21. Përditësimi i të dhënave në GIS.....	31
Tabela 22. Shpërndarja e konsumatorëve ilegalë sipas zonave	38
Tabela 23. Indikatorët e performancës.....	38
Tabela 24. Lëvizja e punonjësve gjatë vitit 2025.....	45
Tabela 25. Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve	45
Tabela 26. Statistika; Profesionale dhe Gjimore e KRUM – 2025 Sipas Njësive	45
Tabela 27. Të dhënat mbi lëndët përmbartimore.....	46
Tabela 28. Të dhënat mbi lëndët sipas muajve.....	46
Tabela 29. Aktivitetet e prokurimit.....	48

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Inkasimi sipas kategorive (%)	22
Figura 2 Struktura Organizative	47

SHKURTESAT

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni Statistikor i Kosovës
BD	Bordi i Drejtorëve
CRM	Customer Relationship Management (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë)
ITU	Impianti për Trajtimin e Ujit
ITUZ	Impianti për Trajtimin e Ujrave të Zeza
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KRUM	Kompania Rajonale Ujësjetëse "Mitrovica"
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Rreziqet

Te nderuar,

Viti 2025 përfaqëson një moment të rëndësishëm në zhvillimin e KRU "Mitrovica" Sh.A. Progresi i arritur gjatë këtij viti e vendos kompaninë në një pozitë më të fortë për të hyrë në një fazë të re të konsolidimit, integritimit dhe investimeve strategjike. Përkundër një mjedisi sfidues, të karakterizuar nga presione financiare dhe zgjerim të përgjegjësive, kompania ka ruajtur fokus të qartë në mandatin e saj themelor: ofrimin e shërbimeve të sigurta, të besueshme dhe cilësore për qytetarët në të gjithë zonën e saj të shërbimit.

Një nga zhvillimet më domethënëse të vitit ishte integrimi i shërbimeve në komunat veriore, përfshirë Mitrovicën Veriore, Zveçanin dhe Zubin Potokun. Ky proces përbën një hap strategjik me ndikim afatgjatë, duke zgjeruar rolin institucional të kompanisë dhe duke vendosur themelet për një sistem më të unifikuar, më efikas dhe më cilësor të ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët e rajonit të Mitrovicës.

Në të njëjtën kohë, kompania ka shënuar përmirësim të dukshëm në performancën operative dhe komerciale, niveli i ujit të pafaturuar është ulur ndërsa faturimi dhe inkasimi kanë shënuar rritje të qartë krahasuar me vitin paraprak. Progres është arritur edhe në zhvillimin e projekteve strategjike infrastrukturore, përfshirë avancimin e projektit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë si EBRD dhe EIB.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Drejtorëve ka ushtruar funksionin e tij me përgjegjësi të plotë, duke siguruar mbikëqyrje aktive dhe orientim strategjik. Janë miratuar dokumente të rëndësishme rregullative dhe planifikuese, janë forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe është kërkuar adresim më sistematik i gjetjeve të auditimit, me synim forcimin e llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë korporative.

Sfidat dhe prioritetet përpara

Përkundër progresit të arritur, kompania do të përballet me sfida të rëndësishme në periudhën në vijim. Rritja e kostove operative, veçanërisht e energjisë elektrike, mbetet një nga rreziqet kryesore për stabilitetin financiar dhe kërkon fokus të shtuar në efikasitet energjetik, optimizim të operimit dhe kontroll më të mirë të shpenzimeve.

Njëkohësisht, reduktimi i mëtejshëm i humbjeve të ujit, përmirësimi i menaxhimit të aseteve dhe ruajtja e performancës së inkasimit do të jenë përcaktuese për forcimin e qëndrueshmërisë operationale dhe financiare të kompanisë. Po aq e rëndësishme mbetet edhe konsolidimi i plotë i procesit të integritimit në veri, krahas avancimit të projekteve kapitale strategjike dhe sigurimit të burimeve të qëndrueshme të financimit, në një kohë kur kërkesat për standarde më të larta të shërbimit, mbrojtjes së mjedisit dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike janë në rritje.

Shikimi drejt së ardhmes

Të arriturat e vitit 2025 përbëjnë një bazë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të kompanisë. Fokusi ynë mbetet i qartë: forcimi i qëndrueshmërisë financiare, përmirësimi i performancës operative dhe ofrimi i shërbimeve cilësore për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Në emër të Bordit të Drejtorëve, shpreh mirënjohjen time për menaxhmentin, stafin dhe të gjithë partnerët për angazhimin dhe përkushtimin e tyre gjatë këtij viti. Ne mbetemi të përkushtuar për të avancuar më tej këtë progres dhe për të ndërtuar një kompani moderne, efikase dhe të qëndrueshme në shërbim të interesit publik.

Kumrije Kelmendi Aliu
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
KRU "Mitrovica" Sh.A.

Ky Raport Vjetor 2025 është përgatitur në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe pasqyron performancën e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Mitrovica" (KRUM) gjatë periudhës janar – dhjetor 2025. Raporti thekson arritjet dhe sfidat e ndërmarrjes, duke u fokusuar kryesisht në garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm, si dhe në ofrimin e shërbimeve efikase dhe të besueshme të ujit dhe kanalizimit për komunitetin.

Qëllimi i këtij raporti është jo vetëm të pasqyrojë aktivitetet e realizuara gjatë vitit raportues, por edhe të vlerësojë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit për vitin 2025. Ai ofron një analizë të detajuar të performancës së ndërmarrjes, duke identifikuar arritjet kryesore, sfidat e hasura dhe fushat ku janë të nevojshme përmirësime, për të mundësuar një qasje më të strukturuar drejt optimizimit të shërbimeve dhe efikasitetit operativ.

Raporti përfshin të dhëna të hollësishme mbi të gjitha sektorët operativë të KRUM-it, duke përfshirë prodhimin, shpërndarjen, faturimin dhe arkëtimin, si dhe një analizë të shpenzimeve të përgjithshme dhe të performancës financiare. Ky dokument siguron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi zhvillimet teknike dhe financiare, duke mundësuar vlerësimin e progresit të kompanisë drejt objektivave strategjike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve.

1.1.1 Aktivitetet dhe performanca e KRU "Mitrovica"

Gjatë vitit 2025, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" (KRUM) ka vazhduar angazhimin e saj për të përmbushur misionin kryesor: sigurimin e furnizimit të rregullt, të qëndrueshëm dhe në sasi të mjaftueshme me ujë të pijshëm, duke respektuar standardet më të larta të cilësisë për të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin e ujësjellësit.

Duke marrë parasysh kapacitetet përpunuese të Impiantit të Trajtimit të Ujit (ITU) në Shipol dhe Balinc, kompania ka garantuar një shpërndarje të balancuar dhe të qëndrueshme të ujit të pijshëm në të gjitha komunat që mbulohen nga shërbimet e KRUM-it.

Ky proces menaxhohet me kujdes të veçantë për të siguruar furnizim efikas dhe të pandërprerë, duke optimizuar njëkohësisht përdorimin e burimeve ekzistuese dhe duke minimizuar humbjet në rrjet.

1.1.2 Të dhënat mbi drejtorët jo-ekzekutiv

Bordi i Drejtorëve të KRU “Mitrovica” Sh.A., i emëruar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/81, datë 01.06.2022, si dhe me Vendimin për plotësim/ndryshim nr. 03/182, datë 10.01.2024 në përbërje prej znj. Kumrije Kelmendi Aliu - Kryesuese, z. Zijadin Lutolli - Anëtar, z. Bashkim Halabaku - Anëtar, Aurora Dinaj - Anëtare, gjatë vitit 2025 ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e tij me përkushtim, përgjegjësi dhe transparencë të plotë.

Të gjitha veprimet dhe aktivitetet janë zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe në harmoni me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative të Ndërmarrjeve Publike.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsej trembëdhjetë (13) takime, nga të cilat nëntë (9) kanë qenë të rregullta, dy (2) të jashtëzakonshme dhe një (1) takim vjetor me aksionarin.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për anëtarët e Bordit të Drejtorëve për periudhën 01.01.2025 – 24.12.2025, duke përfshirë informacionin për përbërjen dhe angazhimin e tyre gjatë kësaj kohe.

Tabela 1. Bordi i Drejtorëve jo – ekzekutiv

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr. i mbledhjeve prezent
1.	Kumrije Kelmendi Aliu	Kryesuese	13
2.	Zijadin Lutolli	Anëtar	7
3.	Bashkim Halabaku	Anëtar	13
4.	Aurora Dinaj	Anëtar	12

Komisioni i Auditimit të Brendshëm është emëruar me Vendimin e Ministrisë së Ekonomisë, nr. 1339, datë 07.06.2022, si dhe me Vendimin nr. 723, datë 29.01.2024, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 1339, datë 07.06.2022, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë për përbërjen e Komisionit të Auditimit. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Komisioni i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar gjithsej dhjetë (10) takime.

Tabela 2. Komisioni i Auditimit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr. Mbledhjeve prezent
-----	------------------	--------	------------------------

1.	Zijadin Lutolli	Kryesues	10	10
2.	Bashkim Halabaku	Anëtar	10	
3.	Aurora Dinaj	Anëtare	9	9

Të gjitha aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe, që lidhen me fushën e auditimit të brendshëm, janë zhvilluar në përputhje me Planin Vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2025, si dhe në bazë të kërkesave dhe udhëzimeve shtesë të Komisionit të Auditimit.

Në përputhje me planin e punës, në periudhën janar - shtator 2025 (deri në dorëheqjen e zyrtares nga kjo pozitë), gjatë së cilës kompania kryer auditime nga Zyrtarja e Auditimit të Brendshëm, me ç'rast janë aprovuar gjithsej gjashtë (6) raporte të auditimit të brendshëm:

- Raporti i Auditimit të Brendshëm – Menaxhimi i Prokurimit
- Raporti i Auditimit të Brendshëm – Menaxhimi i Pasurisë
- Raporti i Auditimit të Brendshëm – Menaxhimi i Proceseve në Fabrika
- Raporti i Auditimit të Brendshëm – Menaxhimi i Shërbimeve Komeriale dhe Rrjetit Shpërndarës
- Raporti gjashtëmujor i Auditimit të Brendshëm
- Raporti i Auditimit të Brendshëm – Menaxhimi i Shpenzimeve

Tabela 3. Aprovimi i Rregulloreve/Planeve/Raporteve për periudhën 2025 nga Bordi i Drejtorëve

Nr.	Emri	Aprovimi
1	Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.1347/2 mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës të KRUM-së	Aprovuar
2	Rregullore për përdorimin e Automjeteve Zyrtare të KRUM-së	Aprovuar
3	Statuti i KRUM-së	Aprovuar
4	Plani për Monitorimin e Ujit të Pijshëm	Aprovuar
5	Rregullore për Procedurat e Rekrutimit në Kompaninë Rajonale Ujësjellësi " Mitrovica" Sh. A - Mitrovicë	Aprovuar
6	Struktura Organizative e KRUM-it me ndryshimet e propozuara, duke përfshirë shtimin e njësisë organizative në Mitrovicën Veriore/Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe FTU – Zubin Potok	Aprovuar
7	Plani Rishikuar të Biznesit 2025-2027	Aprovuar
8	Rregullore për Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRUM	Aprovuar

9	Planin e Biznesit 2026-2028	Aprovuar
11	Raportin e Auditorit të për pasqyrat financiare të audituara për vitin 2024 dhe letrën për menaxhmentin e dërguar nga Auditori i Jashtëm	Aprovuar
12	Raportet mujore dhe tremujore (TM1, TM2, TM3, TM4)	Aprovuar
13	Vendim që të caktohen afate strikte kohore për adresimin e gjetjeve të evidentuara nga raporti i auditimit të brendshëm, përveç përcaktimit të afateve, të përcaktohen edhe mekanizmat dhe masat konkrete ndërhyrëse të cilat do të mundësojnë eliminimin të këtyre gjetjeve dhe parandalimin e përsëritjes së tyre në të ardhmen si dhe progresi i tyre të jetë si shtojcë e raportit të performances mujore të kompanisë.	Aprovuar
14	Aprovon Bonusin për Fund vit në vlerë prej 100 euro	Aprovuar
15	Aprovon rritjen e pagave në mënyrë lineare prej 100 euro	Aprovuar
16	Miraton propozimi për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë	Aprovuar
17	Miraton Strukturën Organizative e KRUM-it me ndryshimet e propozuara, duke përfshirë shtimin e njësisë organizative në Mitrovicën Veriore/Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe FTU – Zubin Potok.	Aprovuar
18	Aprovon ngritjen e shujtës nga katër(4) në pesë (5)	Aprovuar

Raporti i pagës bazë së drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit

Gjatë vitit 2025 pagesat e drejtorëve janë trajtuar në pajtim me Ligjin mbi të ardhurat personale. Pagat e përfituara nga drejtoret e Bordit të Drejtorëve janë tatuar në shkallën 10% (punë dytësore). Pagesa bruto është bërë në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/81, të datës 23.03.2016. Individualisht drejtorët kanë përfituar sipas listës më poshtë (vjetore). Pagesës bazë i është shtuar edhe pjesa prej 5% e paguar nga KRU "Mitrovica" Sh.A., në llogari individuale tek Trusti i Sigurimeve Pensionale të Kosovës:

Tabela 4: Paga bazë për Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin e Auditimit gjatë vitit 2025

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Paga bazë gjatë vitit 2025
1.	Kumrije Kelmendi Aliu	Kryesuese	5,400 euro
2.	Zijadin Lutolli	Anëtar	5,160 euro
3.	Bashkim Halabaku	Anëtar	4,800 euro
4.	Aurora Dinaj	Anëtare	4,800 euro
	Gjithsej		20,160 euro

2.1 Hyrje

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Mitrovica" (KRUM) operon mbi bazën e parimeve dhe funksioneve kryesore, të cilat përfshijnë ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe cilësore përmes furnizimit me ujë të pijshëm sipas standardeve të përcaktuara dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit. Po ashtu, kompania është e angazhuar në trajtimin e pjesshëm të ujërave të ndotura, duke synuar përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë vitit 2025, KRUM ka qenë vazhdimisht i përkushtuar në përmirësimin e shërbimeve dhe ngritjen e imazhit të kompanisë, duke vendosur konsumatorin në qendër të veprimtarisë dhe duke u fokusuar në përmbushjen e pritshmërive të tij.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, raporti vjetor përbën një detyrim ligjor dhe pasqyron performancën e kompanisë bazuar në objektivat e përcaktuara në Planin e Biznesit për periudhën janar – dhjetor 2025, me theks të veçantë në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe në ofrimin e shërbimeve efikase të ujësjetës dhe kanalizimit.

Raporti luan një rol kyç në vlerësimin e përmbushjes së objektivave, si dhe në analizimin e zhvillimeve më të rëndësishme në kompani, si në aspektin financiar ashtu edhe në atë teknik. Ai prezanton arritjet e ndërmarrjes dhe progresin drejt objektivave strategjike.

Në këtë raport janë përfshirë të dhëna të detajuara mbi sektorët kryesorë operativë të kompanisë, duke përfshirë:

- Prodhimin e ujit të pijshëm
- Shpërndarjen dhe distribuimin
- Faturimin
- Inkasimin
- Shpenzimet operative

2.2 Ngjarjet kryesore të vitit

Ndër zhvillimet kryesore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me komunat veriore në janar 2025, duke krijuar bazën institucionale për integrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në këtë pjesë të vendit në kuadër të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica”.
- Marrja në menaxhim e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në veri, përfshirë Mitrovicën Veriore, Zveçanin dhe Zubin Potokun, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt integritetit të shërbimeve dhe standardizimit të operimeve në përputhje me praktikën dhe legjislacionin në fuqi.
- Fillimi i procesit të integritetit të stafit ekzistues në strukturat e KRUM, duke përfshirë harmonizimin e procedurave operacionale, organizative dhe administrative, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit.
- Avancimi i projektit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) në bashkëpunim me konsorciumin TEMPO-IRD, një projekt strategjik për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e trajtimit të ujërave të ndotura në rajon.
- Zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare, përfshirë Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Bankën Evropiane të Investimeve (EIB), për financimin dhe realizimin e projekteve të rëndësishme infrastrukturore në sektorin e ujit dhe kanalizimit.
- Digjitalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përmirësuar menaxhimin e aseteve, monitorimin e rrjetit dhe efikasitetin operativ të kompanisë.
- Zgjerimi i partneriteteve strategjike me institucione vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të zhvillimit të projekteve të reja infrastrukturore dhe rritjes së kapaciteteve institucionale.
- Ligjerata edukative në shkolla fillore me qëllim të ngritjes së vetëdijes të brezit të ri për rëndësinë e ujit të pijshëm,
- Vizita studimore në Impiantet për Trajtimin e Ujit të Pijës dhe Ujërave të ndotura,
- Shënimi i ditës Botërore të Ujit (22 mars), dhe realizimi i fushatave sensibilizuese për përdorimin e qëndrueshëm të ujit dhe rëndësinë e pagesës së shërbimeve.
- Vizita e fëmijëve në objektin qendror të KRUM me rastin e ditës shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit etj.

2.3 Përfundim

Këto zhvillime kanë kontribuar në forcimin e rolit të KRUM si një ndër aktorët kryesorë në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe duke krijuar bazën për investime të mëtejshme strategjike në infrastrukturën ujore të rajonit.

2.4 Pasqyrë e përfomancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të përfomancës

Gjatë vitit 2025, KRU "Mitrovica" Sh.A. ka operuar në një mjedis sfidues, por njëkohësisht me zhvillime të rëndësishme në aspektin operacional, financiar dhe organizativ. Performanca e kompanisë gjatë kësaj periudhe është ndikuar nga rritja e faturimit dhe inkasimit, përmirësimi gradual i disa treguesve të efikasitetit, proceset e integritit të komunave Veriore në zonën e shërbimit, si dhe nga presioni i vazhdueshëm i kostove operative, në veçanti i energjisë elektrike. Analiza në vijim paraqet treguesit kyç të përfomancës sipas njësive operative dhe në nivel të përgjithshëm të kompanisë, duke ofruar një pasqyrë krahasuese ndërmjet viteve 2024 dhe 2025, me theks të veçantë në prodhim, faturim, inkasim, shpenzime, ujë të pafaturuar dhe mbulim operativ.

Gjatë vitit 2025, zhvillimet në veri dhe procesi i integritit të shërbimeve kanë pasur ndikim të rëndësishëm në përfomancën e përgjithshme të kompanisë. Përfshirja graduale e komunave Veriore (Zubin Potok, Mitrovica Veriore dhe Leposaviq) në aspektin e menaxhimit paraqet një ndryshim strukturor për KRU "Mitrovica" dhe duhet trajtuar si proces tranzicioni me ndikim si në volumet operative, ashtu edhe në treguesit financiarë. Për këtë arsye, treguesit e veriut duhen interpretuar ndaras nga njësitet standarde operative, duke marrë parasysh natyrën specifike të shërbimit dhe fazën e integritit institucional dhe operacional.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2025 ka qenë rritja e ndjeshme e kostos së energjisë elektrike, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e shpenzimeve operative në të gjitha njësitet si pasojë e daljes në tregun e lirë të energjisë. Ky mbetet një nga faktorët kryesorë të presionit financiar për kompaninë dhe kërkon masa të vazhdueshme për efikasitet energjetik, optimizim të operimit të pompave dhe menaxhim më të kujdesshëm të konsumit.

Tabela 5: Mitrovicë – Indikatorët kyç të përfomancës

MUAJI	2024	2025	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	12,084,961	11,560,188	(524,773)	-4%
Faturimi m3	3,879,742	4,143,191	263,449	7%
Faturimi nga uji €	2,176,423	2,562,813	386,387	18%
Faturimi- te tjera €	23,063	19,476	(3,587)	-16%
Faturimi Total pa TVSH€	2,199,486	2,582,279	382,794	17%
Faturimi total me TVSH	2,377,701	2,790,809	413,108	17%
Inkasimi nga uji €	2,337,534	2,666,150	328,616	14%

Inkasimi - te tjera €	23,422	23,067	(355)	-2%
Inkasimi Total €	2,360,955	2,689,217	328,261	14%
Nr. i Konsumatorëve	23,823	24,819	996	4%
% e inkasimit	99%	96%		-3%
Shpenzimet	2,400,577	2,806,340	405,763	17%
Pagat	1,276,042	1,410,551	134,509	11%
Rryma elektrike	516,721	777,707	260,987	51%
Shpe. e derivateve	18,085	18,654	569	3%
Miremb. Dhe riparimet	58,477	70,895	12,418	21%
Kemikalet	50,744	41,347	(9,397)	-19%
Shp. - Iber Lepenci	354,610	345,942	(8,669)	-2%
Shpenzimet tjera	125,898	141,244	15,346	12%
Uji I pafaturuar në m3	8,205,219	7,416,997	(788,222)	-10%
Uji I pafaturuar ne %	68%	64%		-4%
Mbulimi operativ	98%	96%		-3%

Nga tabela e mësipërme, shihet se gjatë vitit 2025 në njësinë e Mitrovicës janë prodhuar 11,560,188 m³ ujë, ndërsa janë faturuar 4,143,191 m³, që paraqet rreth 36% të sasisë së prodhuar. Pjesa tjetër prej 7,416,997 m³, apo 64%, mbetet ujë i pafaturuar. Krahasuar me vitin 2024, vërehet një përmirësim i dukshëm i këtij treguesi, pasi niveli i ujit të pafaturuar ka rënë nga 67.90% në 64.16%, përkatësisht për rreth 4 pikë përqindje.

Faturimi total me TVSH për vitin 2025 ka arritur në 2,790,809 €, prej të cilit 2,562,813 € janë të ardhura nga shitja e ujit, ndërsa pjesa tjetër nga të hyrat tjera. Krahasuar me vitin 2024, faturimi total pa TVSH është rritur për 17%, ndërsa faturimi nga uji është rritur për 18%, duke reflektuar rritje të volumit të faturuar dhe efektin e zgjerimit të bazës së konsumatorëve.

Inkasimi total në Mitrovicë gjatë vitit 2025 ka arritur në 2,689,217 €, ose 14% më shumë se në vitin paraprak. Megjithatë, përqindja e inkasimit ka rënë nga 99% në 96%, çka tregon se edhe pse arkëtimi në vlerë absolute është rritur, ritmi i inkasimit nuk ka ndjekur plotësisht rritjen e faturimit.

Numri i konsumatorëve ka arritur në 24,819, me një rritje prej 996 konsumatorë ose 4% krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje lidhet me zgjerimin e shërbimit, përfshirjen e konsumatorëve të rinj në sistem, si dhe me aktivitetet e vazhdueshme në evidentimin dhe formalizimin e lidhjeve.

Shpenzimet operative kanë arritur në 2,806,340 €, duke shënuar rritje prej 17%. Rritja më e theksuar evidentohet te energjia elektrike, e cila ka arritur në 777,707 €, ose 51% më shumë se në vitin 2024. Ky tregues paraqet presion të konsiderueshëm mbi kostot operative, njësoj si në raportin e vitit paraprak ku energjia elektrike paraqitet ndër zërat kryesorë të kostos. Gjithashtu janë rritur pagat, mirëmbajtja dhe shpenzimet tjera, ndërsa te kemikalet dhe shpenzimet për Ibër Lepenc janë vërejtur ulje relative. Në raportin 2024, mbulimi operativ dhe niveli i humbjeve të ujit janë trajtuar si tregues qendrorë të performancës së njësive operative

Përkundër rritjes së shpenzimeve, njësia e Mitrovicës ka ruajtur një mbulim operativ prej 95.83%, që nënkupton se të hyrat operative mbulojnë pjesën më të madhe të kostove, por jo plotësisht. Në periudhën raportuese kërkohet fokus i vazhdueshëm në uljen e humbjeve të ujit, rritjen e efikasitetit të inkasimit dhe kontrollin e kostove të energjisë elektrike.

Tabela 6. Vushtrri – Indikatorët kyç të performancës

MUAJ	2024	2025	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI%
Prodhimi m3	7,683,012	7,364,173	(318,839)	-4%
Faturimi m3	2,849,835	3,470,707	620,872	22%
Faturimi nga uji €	1,506,287	1,928,722	422,435	28%
Faturimi- te tjera €	267	126	(141)	-53%
Faturimi Total pa TVSH€	1,506,554	1,928,193	421,639	28%
Faturimi total me TVSH	1,626,203	2,082,461	456,258	28%
Inkasimi nga uji €	1,587,023	2,095,347	508,324	32%
Inkasimi - te tjera €	217	669	452	208%
Inkasimi Total €	1,587,240	2,096,016	508,776	32%
Nr. i Konsumatorëve	19,035	21,501	2,466	13%
% e inkasimit	98%	101%		3%
Shpenzimet	1,209,791	1,529,901	320,110	26%

Pagat	717,781	771,876	54,094	8%
Rryma elektrike	218,901	474,740	255,839	117%
Shpe. e derivateve	11,232	11,918	685	6%
Miremb. Dhe riparimet	10,329	12,156	1,827	18%
Kemikalet	28,775	16,622	(12,154)	-42%
Shp. - Iber Lepenci	159,138	155,980	(3,158)	-2%
Shpenzimet tjera	63,634	86,610	22,976	36%
Uji I pafaturuar në m3	4,833,177	3,893,466	(939,711)	-19%
Uji I pafaturuar ne %	63%	53%		-10%
Mbulimi operativ	131%	137%		6%

Nga tabela e mësipërme shihet se gjatë vitit 2025, njësia operative e Vushtrrisë ka prodhuar 7,364,173 m³ ujë, ndërsa ka faturuar 3,470,707 m³, që përfaqëson rreth 47% të sasisë së prodhuar. Si rezultat, niveli i ujit të pafaturuar ka rënë në 53%, nga 63% sa ishte në vitin 2024, që paraqet një përmirësim shumë të rëndësishëm prej 10 pikë përqindje.

Faturimi total pa TVSH ka arritur në 1,928,915 €, ndërsa faturimi nga uji në 1,928,722 €, duke shënuar rritje prej 28% krahasuar me vitin paraprak. Edhe inkasimi ka shënuar performancë shumë pozitive, duke arritur në 2,096,016 €, ose 32% më shumë se në vitin 2024. Përqindja e inkasimit prej 101% tregon jo vetëm inkasim të faturimit aktual, por edhe arkëtim të një pjese të borxheve të mëhershme.

Numri i konsumatorëve është rritur në 21,501, me një shtesë prej 2,466 konsumatorë ose 13% krahasuar me vitin 2024. Ky zhvillim tregon zgjerim të mbulimit me shërbime dhe përmirësim të regjistrit të konsumatorëve.

Shpenzimet operative kanë arritur në 1,529,901 €, që paraqet rritje prej 26% krahasuar me vitin paraprak. Rritja më e theksuar është te energjia elektrike, e cila është rritur në 474,740 €, ose 117%, dhe kjo paraqet sfidën kryesore të kostos për njësinë. Në raportin vjetor 2024, për Vushtrrinë theksohet se humbjet e ujit mbesin një tregues problematik dhe se shpenzimet operative duhen analizuar sipas kategorive për të identifikuar mundësi optimizimi.

Megjithatë, pavarësisht rritjes së kostove, mbulimi operativ ka arritur në 137%, duke treguar performancë shumë të mirë financiare të njësisë. Për vitin 2025, Vushtrria paraqitet si njësia me përmirësimin më të madh në uljen e ujit të pafaturuar dhe me rritje të fortë të faturimit dhe inkasimit.

Tabela 7. Skenderaj - Indikatorët kyç të performancës

MUAJI	2024	2025	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	2,890,800	2,778,451	(112,349)	-4%
Faturimi m3	983,786	1,000,730	16,944	2%
Faturimi nga uji €	579,894	639,616	59,722	10%
Faturimi- te tjera €	6,906	9,475	2,570	37%
Faturimi Total pa TVSH€	586,799	649,091	62,292	11%
Faturimi total me TVSH	634,451	701,966	67,515	11%
Inkasimi nga uji €	702,614	783,877	81,263	12%
Inkasimi - te tjera €	7,357	9,278	1,921	26%
Inkasimi Total €	709,971	793,155	83,184	12%
Nr. i Konsumatorëve	9,491	10,212	721	8%
% e inkasimit	112%	113%		1%
Shpenzimet	650,914	783,867	132,953	20%
Pagat	445,610	457,267	11,657	3%
Rryma elektrike	93,892	206,302	112,409	120%
Shpe. e derivateve	5,362	5,547	185	3%
Miremb. Dhe riparimet	6,143	8,981	2,838	46%
Kemikalet	9,012	7,297	(1,715)	-19%
Shp. - Iber Lepenci	62,578	61,065	(1,512)	-2%
Shpenzimet tjera	28,317	37,408	9,090	32%
Uji I pafaturuar në m3	1,907,014	1,777,721	(129,293)	-7%
Uji I pafaturuar ne %	66%	64%		-2%
Mbulimi operativ	109%	101%		-8%

Nga tabela e mësipërme, njësia operative e Skenderajt gjatë vitit 2025 ka prodhuar 2,778,451 m³ ujë dhe ka faturuar 1,000,730 m³, që përfaqëson rreth 36% të sasisë së prodhuar. Uji i pafaturuar ka rënë lehtë në 64%, nga 66% sa ishte në vitin 2024, duke treguar përmirësim modest, por pozitiv.

Faturimi total pa TVSH ka arritur në 649,091 €, duke shënuar rritje prej 11%, ndërsa të hyrat nga uji janë rritur në 639,616 €, ose 10% më shumë se në vitin paraprak. Inkasimi total ka arritur në 793,155 €,

me rritje prej 12%, ndërsa përqindja e inkasimit prej 113% tregon arkëtim të mirë dhe mbledhje të borxheve të periudhave të mëparshme.

Numri i konsumatorëve është rritur në 10,212, ose për 8% më shumë krahasuar me vitin 2024. Kjo tregon zgjerim të bazës së klientëve dhe përfshirje më të madhe në sistemin e faturimit.

Shpenzimet operative kanë arritur në 783,867 €, me rritje prej 20%. Edhe këtu, rritja më e madhe vërehet te energjia elektrike, e cila është rritur në 206,302 €, ose 120% krahasuar me vitin paraprak. Në raportin vjetor 2024, për Skenderajn theksohet se niveli i lartë i ujit të pafaturuar mbetet tregues që kërkon trajtim të vazhdueshëm, ndonëse njësia mban inkasim dhe mbulim operativ të favorshëm.

Përkundër rritjes së kostove, mbulimi operativ ka mbetur në 101%, që do të thotë se njësia ende arrin të mbulojë kostot operative me të hyrat e realizuara, por me një margjinë më të ngushtë se në vitin 2024.

Tabëla 8. KRU "Mitrovica"- Indikatorët kyç të performancës (pa Komunat Mitrovice Veriore, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq)

MUAI	2024	2025	INDRYSHIMI	INDRYSHIMI,%
Prodhimi m3	22,658,773	21,702,812	(955,961)	-4%
Faturimi m3	7,713,363	8,613,985	900,623	12%
Faturimi nga uji €	4,262,604	5,130,486	867,883	20%
Faturimi- te tjera €	30,236	29,077	(1,158)	-4%
Faturimi Total pa TVSH€	4,292,839	5,159,564	866,724	20%
Faturimi total me TVSH	4,642,895	5,575,236	932,341	20%
Inkasimi nga uji €	4,627,171	5,545,421	918,250	20%
Inkasimi - te tjera €	30,996	33,014	2,018	7%
Inkasimi Total €	4,658,167	5,578,435	920,268	20%

Nr. i Konsumatorëve	52,349	56,532	4,183	8%
% e inkasimit	100%	100%		0%
Shpenzimet	4,261,282	5,120,108	858,826	20%
Pagat	2,439,433	2,639,693	200,260	8%
Rryma elektrike	829,514	1,458,749	629,235	76%
Shpe. e derivateve	34,680	36,120	1,440	4%
Miremb. Dhe riparimet	74,949	92,032	17,083	23%
Kemikalet	88,531	65,265	(23,266)	-26%
Shp. - Iber Lepenci	576,326	562,987	(13,339)	-2%
Shpenzimet tjera	217,849	265,262	47,413	22%
Uji I pafaturuar në m3	14,945,410	13,088,827	(1,856,584)	-12%
Uji I pafaturuar ne %	66%	60%		-6%
Mbulimi operativ	109%	109%		0%

Tabela 9. Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani - Indikatorët kyç të performancës-

MUAJI	2024	2025	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	5,349,166	5,227,494	(121,672)	-2%
Faturimi m3	5,349,162	5,227,497	(121,665)	-2%
Faturimi nga uji €	909,455	888,770	(20,685)	-2%
Faturimi Total pa TVSH€	909,455	888,770	(20,684)	-2%
Faturimi total me TVSH	982,211	959,872	(22,339)	-2%
Nr. i Konsumatorëve	4	4	-	0%

Nga tabela e mësipërme shihet se gjatë vitit 2025 në veriun e Mitrovicës dhe Zveçan janë shpërndarë 5,227,494 m³ ujë, ndërsa janë faturuar 5,227,497 m³. Ky raportim duhet interpretuar në kontekstin specifik të kësaj zone, ku aktiviteti lidhet me furnizimin/shpërndarjen e ujit me shumicë për Komunat Mitrovicë Veriore dhe Zveçan, ashtu siç është sqaruar edhe në raportin vjetor 2024, ku theksohet se KRU

“Mitrovica” ka realizuar shpërndarjen e ujit me shumicë pa përfshirë menaxhimin apo mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit.

Megjithatë, kjo gjendje ka ndryshuar gjatë vitit 2025, pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Shërbime me Komunitet Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq në fillim të vitit, si dhe në bazë të vendimit të Autoritetit Rregullativ të Ujërave të datës 7 tetor 2025, me të cilin KRU “Mitrovica” Sh.A. është pajisur me licencë të re të shërbimit për këto komuna. Me këtë vendim, kompania ka kaluar nga licenca për ofrimin e shërbimeve të ujit me shumicë në licencë për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Për vitin 2025, kjo pjesë duhet të komentohet edhe në kontekstin e ngjarjeve të integritetit në veri, duke qenë se zhvillimet institucionale dhe operacionale të marrëveshjeve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën e furnizimit, monitorimit, faturimit dhe inkasimit në këtë zonë. Si rrjedhojë, treguesit e veriut nuk janë plotësisht të krahasueshëm me njësitë tjera operative, sepse përfshijnë elemente tranzicioni dhe integritetit.

Tabela 10: KRU “Mitrovica” - Indikatorët kyç të performancës

MUAJI	2024	2025	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI%
Prodhimi m3	28,007,939	26,930,306	(1,077,633)	-4%
Faturimi m3	13,062,525	13,842,125	779,600	6%
Faturimi nga uji €	5,172,058	6,019,921	847,863	16%
Faturimi- te tjera €	30,236	29,077	(1,158)	-4%
Faturimi Total pa TVSH€	5,202,294	6,048,998	846,704	16%
Faturimi total me TVSH	5,625,106	6,535,108	910,002	16%
Inkasimi nga uji €	4,627,171	5,545,374	918,203	20%
Inkasimi - te tjera €	30,996	33,014	2,018	7%
Inkasimi Total €	4,658,167	5,578,388	920,221	20%
Nr. i Konsumatorëve	52,353	56,536	4,183	8%
% e inkasimit	83%	85%		3%
Shpenzimet	4,261,282	5,120,108	858,826	20%
Pagat	2,439,433	2,639,693	200,260	8%
Rryma elektrike	829,514	1,458,749	629,235	76%

Shpe. e derivateve	34,680	36,120	1,440	4%
Miremb. Dhe riparimet	74,949	92,032	17,083	23%
Kemikalet	88,531	65,265	(23,266)	-26%
Shp. - Iber Lepenci	576,326	562,987	(13,339)	-2%
Shpenzimet tjera	217,849	265,262	47,413	22%
Uji I pafaturuar në m3	14,945,414	13,088,181	(1,857,233)	-12%
Uji I pafaturuar ne %	53%	49%		-4%
Mbulimi operativ	109%	109%		0%

Nga tabela e mësipërme, KRU "Mitrovica" në total, duke përfshirë edhe furnizimin me shumicë për Mitrovicën Veriore dhe Zveçanin, gjatë vitit 2025 ka prodhuar 26,930,306 m³ ujë dhe ka faturuar 13,842,125 m³, që paraqet rreth 51% të sasisë së prodhuar. Uji i pafaturuar ka rënë në 49%, nga 53% në vitin 2024, që përfaqëson përmirësim të rëndësishëm prej 5 pikë përqindje.

Faturimi total pa TVSH ka arritur në 6,048,998 €, ndërsa inkasimi total në 5,578,388 €. Përqindja e inkasimit është rritur nga 83% në 85%, duke reflektuar progres në mbledhjen e të hyrave. Numri i konsumatorëve është rritur në 56,536, ose 8% më shumë krahasuar me vitin 2024.

Shpenzimet operative kanë arritur në 5,120,108 €, me rritje prej 20%, ndërsa mbulimi operativ ka mbetur në 109%. Rritja më e madhe mbetet te energjia elektrike, e cila është rritur me 76%. Në raportin 2024, performanca e përgjithshme e kompanisë vlerësohet përmes kombinimit të prodhimit, faturimit, inkasimit, humbjeve të ujit dhe mbulimit operativ, dhe i njëjti format logjik është i përshtatshëm edhe për vitin 2025.

Tabela 11. Krahasimi i indikatorëve kyç me Plan të Biznesit

Indikator	Realizim 2025	P. Plan i Biznesit 2025	R. Realizimi
Furnizimi me ujë	26,930,306	27,780,880	97%
Humbjet e ujit	49%	50%	98%
Faturimi nga uji €	6,019,921	6,189,490	97%
Inkasimi nga uji €	5,545,374	5,309,448	104%
Nr. i konsumatorëve	56,536	70,460	80%

Në krahasim me Planin e Biznesit 2025, furnizimi me ujë është realizuar në nivelin 97%, faturimi nga uji po ashtu në 97%, ndërsa inkasimi nga uji ka tejkaluar planin dhe ka arritur 104%. Humbjet e ujit janë realizuar në 98% të planit, që nënkupton se kompania ka arritur nivel pak më të mirë sesa objektivi i planifikuar.

Numri i konsumatorëve është realizuar vetëm në 80% të planit duke reflektuar mos regjistrimin e konsumatorëve në Komunitat Veriore sipas planit për shkak të mos përfundimit të procesit të rekrutimit për pozitat përkatëse. Kjo tregon se zgjerimi i bazës së konsumatorëve nuk ka ecur sipas projeksioneve të planifikuara, edhe pse në treguesit financiarë dhe operacionalë kompania ka ruajtur performancë solide.

2.4.1 Rekapitulimi i inkasimit dhe shpenzimeve

Tabela 12. Inkasimi

Nr	Përshkrimi	Mitrovicë	Vushtrri	Skenderaj	Gjithsejt
1	Amvisni	2,118,565	1,731,511	573,636	4,423,712
2	Biznes	409,500	195,360	164,423	769,283
3	Ekonomi	21,911	36	84	22,031
4	Institucionet	105,814	113,712	45,687	265,213
5	Ndërkombtaret	10,408	54,728	-	65,136
	TOTALI 1	2,666,198	2,095,346	783,830	5,545,374

Nga struktura e inkasimit për vitin 2025, shihet se inkasimi total prej 5,545,374€ dominohet nga kategoria e amvisërisë me 4,423,712€, pasuar nga bizneset me 769,283€, institucionet me 265,213€, ndërkombëtarët me 65,136 €, dhe ekonomia me 22,031 €.

Mitrovica mban pjesën më të madhe të inkasimit total, me 2,666,198 €, e pasuar nga Vushtrria me 2,095,346 € dhe Skenderaj me 783,877 €. Kjo strukturë tregon se baza kryesore e arkëtimit vazhdon të mbështetet në konsumatorët familjarë, ndërsa bizneset përbëjnë kategorinë e dytë më të rëndësishme për të hyrat e kompanisë.

2.4.2 Inkasimi në bazë të kategorive

Tabela 13. Inkasimi në euro dhe përqindje sipas kategorive

Kategoria	Inkasimi	%
Amvisni	4,423,712	80%
Biznes	769,283	14%
Ekonomi	22,031	0%
Institucionet	265,213	5%
Ndërkombtaret	65,136	1%
TOTALI 1	5,545,374	100%




Figura 1: Inkasimi sipas kategorive (%)

2.4.4 Shpenzimet

Tabela 14: Shpenzimet vjetore 2023 -2025

Përshkrimi i shpenzimit	2023	2024	2025
Uji i blerë me shumicë	565,402	575,284	563,076
Energjia elektrike	770,205	829,514	1,458,749
Karburanti	35,419	31,437	37,165
Lëndë djegëse			
Pagat e punëtorëve	2,196,404	2,420,213	2,629,090
Pagat e bordit	16,128	20,993	21,168
Ushqimi i punëtorëve			
Shpenzimet materiale	44,120	15,735	16,844

Material për higjienë	2,553	2,218	1,072
Rroba mbrojtëse ne punë	766	1,517	3,950
Analizat e ujit	11,378	13,965	15,146
Kemikatet	162,159	88,863	65,267
Transporti i mall. & shërb.	-	-	-
Telefonia mobile	8,537	8,295	9,150
ARU Licenca	41,726	53,587	51,652
Tatimi në pronë	796	1,325	3,740
Taksa Gjyqësore	-	1,625	-
Shukosi	11,172	12,728	12,240
Internet	1,712	1,763	1,902
Bartja e mbeturinave	197	1,086	653
Pjesmarrja në konferenca	6,079	12,417	12,441
Qiraja	17,055	15,824	15,823
Sigurimi i automjeteve	-	4,922	4,351
Anëtarësimi	-	-	-
Kamatat	9,044	11,111	7,328
Përmbaruesi	43,124	12,207	19,842
Auditimi	-	1,605	1,258
Konkurset	2,840	2,182	2,345
Reprezentacion	12,155	8,980	14,460
Byfe	1,081	1,227	2,547
Udhëtim zyrtar	7,075	4,347	7,876
Dhurata	-	724	1,157
Reklama	-	16	508
Provizion Bankar	7,198	10,203	11,418
Rekreacion për punonjës	-	739	303
Mirëmbajtje	-	78,283	92,034
Demtimi i tokes	-	-	-
Borgji i keq	320,356	313,356	283,491
Shpenzimet tjera	80,689	31,165	36,016
Totali	4,375,370	4,589,456	5,404,062

Nga analiza e shpenzimeve vjetore shihet se totali i shpenzimeve është rritur nga 4,589,456 € në vitin 2024 në 5,404,062€ në vitin 2025. Rritja kryesore vjen nga energjia elektrike, e cila ka arritur në 1,458,749€ dhe paraqet shtyllën kryesore të rritjes së kostove operative. Po ashtu, janë rritur pagat e punëtorëve, mirëmbajtja, përfaqësimi ligjor, provizionet bankare dhe disa zëra të tjerë administrativë. Nga ana tjetër, janë ulur shpenzimet për kemikale, ujin e blerë me shumicë, përmbaruesin dhe disa kategori tjera, çka ka ndihmuar në zbutjen e pjesërishme të presionit të kostove. Në raportin 2024 theksohet se pjesa më e madhe e kostove përbëhet nga pagat, energjia elektrike dhe Ibër Lepenci, si dhe

shpjegohet se lëvizjet në paga dhe kosto operative duhen lexuar në kontekst të ndryshimeve organizative dhe të kostove të furnizimit

Tabela 15: Shpenzimet në euro dhe përqindje pa borxhin e keq

Shpenzimet	Vlera	%
Pagat	2,650,258	52%
Energjia elektrike	1,458,749	28%
Iber Lepenci	563,076	11%
Kemikalet	65,267	1%
Derivatet	37,165	1%
ARRU	51,652	1%
Shp. e perfaqesimit Ligjor	19,842	0%
Mirembajtje	92,034	2%
Te tjera	182,063	4%
Total	5,120,107	100%

Nga struktura e shpenzimeve pa përfshirë borxhin e keq, shihet se pagat përbëjnë 52% të totalit, energjia elektrike 28%, ndërsa Iber Lepenci 11%. Këta tre zëra së bashku përbëjnë pjesën dërrmuese të kostove operative të kompanisë. Krahasuar me modelin e raportimit të vitit 2024, ku pagat, energjia elektrike dhe Iber Lepenci paraqiten si zërat dominues të shpenzimeve, edhe për vitin 2025 del qartë se menaxhimi i kostove duhet të fokusohet pikërisht në këto kategori. Në veçanti, energjia elektrike ka marrë peshë shumë më të lartë në strukturën e kostove, duke e rritur ndjeshëm ekspozimin financiar të kompanisë ndaj lëvizjeve të çmimeve në tregun energjetik

2.5 SHËRBIMI TEKNIK

Gjatë vitit 2025, Departamenti Teknik i KRU "Mitrovica" Sh.A ka realizuar një sërë aktivitesh dhe ndërhyrjesh konkrete në funksion të arritjes së objektivave strategjike të ndërmarrjes, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, rritjen e efikasitetit dhe zgjerimin e kapaciteteve operative.

Arritjet sipas objektivave strategjike

Cilësia e ujit është garantuar përmes funksionimit të qëndrueshëm të sistemeve të trajtimit dhe kontrollit të vazhdueshëm laboratorik, duke siguruar përputhshmëri me standardet e ujit të pijshëm dhe kërkesat e shëndetit publik. Efikasiteti operacional është përmirësuar përmes optimizimit të proceseve teknike, digjitalizimit të stacioneve të pompimit dhe menaxhimit më të mirë të aseteve dhe operacioneve në terren. Zhvillimi i infrastrukturës është avancuar përmes planifikimit të projekteve të reja, përgatitjes së paramasave dhe investimeve në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit. Inovacioni dhe teknologjia janë integruar përmes projekteve të digjitalizimit dhe bashkëpunimit me partnerë zhvillimorë, duke mundësuar monitorim më efikas dhe vendimmarrje më të bazuar në të dhëna. Menaxhimi i riskut është forcuar përmes implementimit të Planit të Sigurisë së Ujit dhe identifikimit të pikave kritike në sistem. Përputhshmëria me rregulloret është siguruar përmes respektimit të standardeve ligjore, procedurave të ARRU dhe bashkëpunimit me institucionet përkatëse. Zvogëlimi i humbjeve të ujit është trajtuar si prioritet strategjik, duke filluar zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projekteve për reduktimin e ujit të pafaturuar, përfshirë analizën e rrjetit dhe definimin e zonave DMA. Këto arritje janë në përputhje me objektivat strategjike të ndërmarrjes, që synojnë rritje të qëndrueshme, kënaqshmëri më të lartë të konsumatorëve dhe mbrojtje të mjedisit.

Menaxhimi dhe operimi në komunat veriore

Gjatë vitit 2025, pas nënshkrimit të marrëveshjes për zgjerimin e zonës së shërbimit në komunat veriore të Kosovës, KRU "Mitrovica" ka ndërmarrë hapa konkretë për funksionalizimin dhe konsolidimin e operimit në këtë zonë.

1. Organizimi dhe funksionimi institucional

Struktura organizative është funksionalizuar në përputhje me planin operativ të miratuar, ndërsa procesi i rekrutimit për pozitat e parashikuara është inicuar për të forcuar kapacitetet në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Ky proces ka krijuar bazën për një menaxhim të qëndrueshëm dhe efikas të shërbimeve në zonën e re të operimit.

2. Operimi i fabrikës së ujit në Zubin Potok

Fabrika e ujit në Zubin Potok ka operuar në mënyrë të pandërprerë (24/7), përmes një modeli të përbashkët bashkëpunimi ndërmjet tri kompanive rajonale, dy ndërrime të mbuluara nga KRU Mitrovica një ndërrim nga KRU Prishtina dhe një ndërrim nga KRU Gjakova. Operacionet janë mbështetur nga operatorë teknikë, laborantë për kontrollin e cilësisë së ujit, dozatorë për menaxhimin e kimikateve. Mbikëqyrja e përgjithshme është realizuar nga menaxheri i fabrikës së Shipolit, ndërsa mbështetja teknike është ofruar nga ekipi i elektromakinërisë së KRU Mitrovica. Funkionimi gjatë vitit është zhvilluar pa pengesa të theksuara operationale, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë.

3. Menaxhimi i njësive operative në veri

Menaxhimi i operacioneve në komunat veriore është organizuar në mënyrë të koordinuar, duke përfshirë: koordinatorin e zonës së veriut, shefin e rrjetit dhe ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujit. Njësia ITU në Zubin Potok dhe strukturat operative janë integruar sipas organogramit të propozuar, ndërsa mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit është mbuluar nga ekipet teknike nga jugu. Në të njëjtën kohë, procesi i rekrutimit për pozitat e planifikuara është zhvilluar paralelisht, me synim kompletimin e strukturave dhe sigurimin e operimit të plotë dhe efikas në këtë zonë.

2.5.4 Prodhimi

Gjatë vitit 2025 janë prodhuar, respektivisht shpërndarë 26,930,306 m³ që nëse krahasohet me vitin e kaluar del që kemi prodhuar 1,077,633 m³ më pak edhe përkundër pranimin të rrjeteve të reja të ujësjellësit dhe shtimit të numrit të konsumatorëve. Pra, kemi arritur që në nivel rajonal të prodhojmë më pak ujë sesa vitin paraprak. Ky ka qenë një nga objektivat tanë kryesorë drejt zvogëlimit të prodhimit i cili objektivi do të vazhdojë të realizohet edhe në vitet në vijim. Gjatë vitit 2025, nga ITU në Shipol janë shpërndarë 19,566,133 m³, ndërsa ITU Balinc 7,364,173 m³ ujë të pijes kurse në Zubin Potok janë shpërndarë 2,127,689 m³ ujë që nga muaji korrik.

Departamenti Teknik me masat e ndërmarra mbi rrjedhjet në rrjete, puseta dhe rezervuar të cilat janë raportuar nga konsumatorët apo zbuluar nga punëtorët e kompanisë janë sanuar brenda një kohe të shkurtër dhe e cila ka ndikuar në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Tabela 16. Distribuimi i ujit sipas ITU-ve

Uji prodhuar - ITU	Shipol m ³	Balinc m ³	Zubin Potok m ³	Total m ³
--------------------	-----------------------	-----------------------	----------------------------	----------------------

Janar	1,708,567	629,760	-	2,338,327
Shkurt	1,496,167	531,884	-	2,028,051
Mars	1,625,469	583,055	-	2,208,524
Prill	1,569,653	591,007	-	2,160,660
Maj	1,617,034	629,635	-	2,246,669
Qershor	1,746,021	708,273	-	2,454,294
Korrik	1,840,685	734,845	353,548	2,575,530
Gusht	1,786,615	729,199	352,000	2,515,814
Shtator	1,621,023	603,629	343,840	2,224,652
Tetor	1,573,762	592,445	361,584	2,166,207
Nentor	1,457,473	458,640	363,169	1,916,113
Dhjetor	1,523,664	571,801	353,548	2,095,465
Totali	19,566,133	7,364,173	2,127,689	26,930,306

**Vërejtje: Duke pasur parasysh se ITU-Zubin Potok ka hyrë nën menaxhimin e KRU Mitrovica në muajin Maj 2025, ka mungesë të të dhënave deri në atë periudhë, ndërsa nga muaji Korrik vlerat e prodhimit janë të paraqitura në tabelë. Si e tillë këtë vit nuk është e përfshirë në vlerat totale për tu krahasuar me vitin paraprak (tab.17).*

Tabela 17. Krahasimi i furnizimit sipas viteve

Ujji i prodhuar ITU-të	Viti 2025 m ³	Viti 2024 m ³	Diferenca m ³ 2025/2024
Janar	2,338,327	2,330,990	7,337.0
Shkurt	2,028,051	2,156,370	-128,319.0
Mars	2,208,524	2,278,131	-69,607.0
Prill	2,160,660	2,231,591	-70,931.0
Maj	2,246,669	2,293,232	-46,563.0
Qershor	2,454,294	2,466,749	-12,455.0
Korrik	2,575,530	2,650,028	-74,498.0
Gusht	2,515,814	2,593,433	-77,619.0
Shtator	2,224,652	2,310,739	-86,087.0
Tetor	2,166,207	2,308,107	-141,900
Nentor	1,916,113	2,148,138	-232,025
Dhjetor	2,095,465	2,240,431	-144,966
Totali	26,930,306.0	28,007,939	-1,077,633.0

2.5.5 Cilësia e ujit

Në laboratorin e ITU në Shipol për monitorimin e cilësisë të ujit janë bërë matjet e parametrave fiziko-kimik për 1,800 mostra, kurse në laboratorin e ITU Balinc janë bërë 2163 mostra për matje të parametrave: temperatura, era, ehija, NTU, pH, KMnO_4 , Cl_2 , eloruret, NH_3 , nitratet, nitritet, përçueshmëria, Fe. IKSHP në kushte normale ka bërë testimin e një mostre të ujit brenda javës për matje të parametrave fiziko-kimik dhe mikrobiologjik. IKSHP po ashtu bënë monitorimin e cilësisë së ujit në bazë të kontratës së rregullt mbi parametrat e ujit të pijes.

Monitorimi i cilësisë të ujit është bërë sipas planit të përputhshmërisë dhe planit të jashtëm.

Rezultatet e analizave për matje të parametrave në laboratorët e Impianteve në Shipol, Balinc dhe rezultatet e IKSHP kanë treguar se uji i trajtuar në Impiantet tona ka qenë në përputhje me standardet për ujë të pijshëm sipas UA 10/2021.

2.5.6 Kimikatet

Gjatë vitit 2025 për trajtim të ujit të pa përpunuar si koagulant kemi përdorur klorurin ferrik, ndërsa si dezinfektues klorin e gaztë në të dy Impiantet. Siç shihet në tabelën më poshtë, kemi shpenzuar 32,788 kg klor të gaztë dhe 151,114 kg koagulant klorur ferrik për Shipol dhe Balinc dhe 895 kg alumin sulfati për Zubin Potok. Sasia e rritur e klorurit ferrik ka ardhur si pasojë e turbullshmërisë së madhe e cila ka qenë prezente gjatë vitit 2025.

Tabela 18: Sasia e kimikateve të shpenzuara

Muaji	Zubin Potok	Shipol	Balinc	Zubin Potok	Shipol	Balinc
	Sulfati i aluminit –kg	Klori gaz kg		Kloruriferrik kg		
Janar	-	1640	778	-	4,800	3,584
Shkurt	-	1724	656	-	6,960	2,576
Mars	-	1832	722	-	6,820	2,340
Prill	-	1,900	755	-	6,730	2,126
Maj	-	1,752	818	-	10,060	2,316
Qershor	-	1,765	903	-	14,500	2,968
Korrik	87	1,765	990	387.5	14,500	2,576
Gusht	105	2,250	1,066	380	6,000	2,410
Shtator	112	1,806	1,005	380	6,398	1,960

Tetor	116	1,950	1,005	390	4,460	1,950
Nëntor	250	2,104	895	374.4	16,680	2,808
Dhjetor	225	1,870	837	372	19,040	6552
Gjithsej	895	32,788		2,283.9		151,114

2.5.7 Sektori i elektro – makinerisë

Gjatë vitit 2025 mirëmbajtja elektro - makinerisë evitoi të gjitha defektet në Stacionet e pompimi dhe ITU-të . Në këtë vit u lubrifikuan dhe ndërruan gjitha kushinetat të cilat kishin kaluar orët e punës të parapara nga prodhuesi. Të gjitha aktivitetet në këtë sektor përfshijnë intervenime si: defekte në pompa, ndërrim i kushinetave, sanim i ormanëve, ndërrim i valvulave e shumë të tjera, të shprehura me vlerë numerike janë gjithsej 234 intervenime. Këto intervenime janë kontrolla rutiore, probleme të identifikuara dhe probleme të zgjidhura.

2.5.8 ITUZ në Skenderaj

Gjatë vitit 2025 janë raportuar se janë trajtuar 592,044 m³ ujëra të zeza. Në laboratorin e impiantit janë marrë 48 mostra dhe janë analizuar nga nëntë (9) parametra, nga secila mostër. Pas trajtimit të ujërave të ndotura, të njëjtat i kanë plotësuar kriteret për tu shkarkuar në lum.

2.5.9 Raporti i Njësive Operative

Gjatë vitit 2025 shpërndarja e ujit të pijes nga ITU Shipol në sasi prej 19,566,133 m³, është shpërndarë si vijon: 59.08 % për Mitrovicën Jugore, 14.20 % për Skenderaj dhe 26.11 % për Veriun e Mitrovicës. Ndërsa ITU Balinc ka furnizuar 100% komunën e Vushtrrisë.

Tabela 19: Shpërndarja sipas njësive operative

Qyteti → Muaji ↓	Mitrovicë Jug	Vushtrri	Skenderaj	Mitrovicë Veri
Janar	1,062,613	629,760	195,200	450,754
Shkurt	865,991	531,884	192,000	438,176
Mars	931,006	583,055	225,000	469,463
Prill	871,151	591,007	230,000	468,502

Maj	918,028	629,635	240,000	459,006
Qershor	1,009,334	708,273	255,308	481,379
Korrik	1,089,055	734,845	254,948	496,682
Gusht	1,041,461	729,199	255,025	490,129
Shtator	924,785	603,629	240,620	455,618
Tetor	959,177	592,445	238,830	375,755
Nentor	914,987	458,640	225,840	316,646
Dhjetor	972,600	571,801	225,680	325,384
Totali	11,560,188	7,364,173	2,778,451	5,227,494

Në të tri njësitë operative; Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, janë pranuar 3,728 ankesa, prej të cilave 2,043 ankesa kanë qenë për rrjetin e ujit dhe 1,685 ankesa kanë qenë për rrjetin e kanalizimit. Ankesat kanë qenë për mirëmbajtje të rrjetit të ujit si: ndërrim i gypit, rrjedhje, montim të ujëmatësve, riparim të ujëmatësve, kyçje të reja, hulumtim të rrjeti për shkak të rrjedhjeve të pa dukshme, riparime të valvuleve si edhe mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit dhe pastrim i rrjetit.

Ankesat/intervenimet	Viti 2025	Viti 2024
Rrjeti i ujësjellësit	2,043	1,751
Rrjeti i kanalizimit	1,685	1,320
Totali	3,728	3,071

2.5.10 Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve

Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e funksionimit të pandërprerë të aktiviteteve të njërive operative gjatë vitit 2024. Aktivitetet e kryera kanë përfshirë kontrollimin e rregullt të gjendjes së automjeteve, servisimin e tyre në mënyrë të planifikuar dhe ndërhyrjet e nevojshme për riparimin e problemeve të mundshme. Po ashtu, janë realizuar regjistrimet e automjeteve dhe janë siguruar që ato të funksionojnë në mënyrë optimale, duke mundësuar zhvillimin e pa pengesë të aktiviteteve ditore. Kjo ka përfshirë edhe monitorimin e kushteve të ndryshme të

automjeteve, si dhe garantimin e furnizimit me materialet dhe lëndët e nevojshme për mirëmbajtjen e tyre. Këto masa kanë siguruar që njësitë operative të kenë automjetet e nevojshme për transportin dhe realizimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurt.

2.2.6 PLANIFIKIMI & ZHVILLIMI

Gjatë vitit 2025 është intensifikuar puna rreth digjitalizimit të rrjetit të ujit dhe kanalizimit, si dhe konsumatorve.

- Monitorimin e rrjedhjes së ujit dhe përpunimin e të dhënave të ndryshme statistikore dhe planifikimin e intervenimeve dhe të ndërrimit në rrjet sipas vjetërsisë së tubacionit.
- Vlerësimin e përgjithshëm të aseteve.
- Është punuar në lidhjen e konsumatorve me GIS-in, me ç'rast kemi arritur që në baza kadastrale, rajonale e më gjerë të identifikojmë borxhlinjë dhe zonat me inkasim më të dobët, hartë kjo e cila do të shërbejë si kontrollës ashtu edhe drejtorisë komerciale për analiza.
- Kemi pranuar shumë kërkesa, rreth kyçjeve, rrjedhjeve, legalizimeve, pëlqimve, etj., të cilat i kemi trajtuar me kohë dhe të njëjtat po i pasqyrojmë më poshtë:

Tabela 20. Kërkesat gjatë vitit 2025

Nr.	Përshkrimi i kërkesave	Viti 2025												total
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
1	Kërkesa të pranuar	50	28	63	72	110	73	68	148	97	120	91	78	998
2	Kërkesa të shqyrtuara	45	23	61	70	107	71	65	145	95	118	85	75	960
3	Kërkesa për Kyçje	0	0	5	5	3	1	3	5	1	4	1	1	29
4	Kërkesa për Ri - Kyçje	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
5	Kërkesa për Legalizim	12	8	27	24	61	37	58	95	46	60	42	38	508
6	Kërkesa për ndërtesa shumëkateshe	7	6	4	2	2	3	1	2	1	1	2	3	34
7	Kërkesa për pëlqime	7	8	12	13	17	12	8	17	21	27	10	4	156
8	Detektimi rrjedhjeve me pajisje - Mitrovicë	18	0	13	25	22	17	1	26	24	25	30	37	228
9	Detektimi i rrjedhjeve në mënyrë vizuale - Mitrovicë	1	0	0	1	2	1	0	1	2	1	0	2	11
10	Evidentimi i kons.në GIS	45	23	61	70	107	71	65	145	95	118	85	75	960

Gjendja në fund të vitit pas fillimit të regjistrimit është pasqyruar në tabelën në vijim.

Tabela 21: Përditësimi i të dhënave në GIS

Përshkrimi

Gjendja aktuale

Nr. i konsumatorëve në sistemin e faturimit	56,535
Nr. Konsumatorëve në GIS	54,020
Diferenca mes Faturimit – GIS	2,515
Nr. I konsumatorëve që kanë nevojë për Verifikim-GIS	45
Konsumatorë:	95,55 %
Nr. i burimeve të ujit/marrjes - GIS	1
Rrjeti primar dhe sekondar	91,54%
Nr. i FPU- GIS	4
Nr. i Rezervuarëve - GIS	66
Stacioneve të Pompimit - GIS	45
Nr. i Valvuleve operuese -GIS	819
Nr. i Valvulave të ajrimit -GIS	48
Nr. Valvulave për reduktimit të shtypjes - GIS	14
Nr. ujëmatësve zonal- GIS	126
Hidrant -GIS	60
Defektet -GIS	7,147
Pompa-GIS	91
Ujëmatësit në prodhim - GIS	5
Rrjeti i kanalizimit në GIS	264,15km
Nr. I Pusetave të kanalizimit në GIS	7057
Nr.i defekteve në GIS	1397

Gjatë vitit 2025, janë realizuar aktivitete të shumta dhe të rëndësishme për zhvillimin dhe përmirësimin e operacioneve në KRU "Mitrovica". Aktivitetet kryesore janë:

1. Vlerësimi dhe kontrolli i infrastrukturës

U realizuan takime dhe vizita në terren me komisionet përkatëse për vlerësimin e gjendjes së rrjetit të ujësjellësit në Burojë. Në kuadër të kësaj u kryen inspektime për pranimin teknik të projektit "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Burojë", ku u konstatuan mangësi teknike dhe projekti nuk u pranua deri në përmirësimin e tyre.

Gjendja e stacioneve të pompimit dhe rezervuarëve në Gushavc, Vinarc dhe Vidimriq u analizua përmes vizitave në terren dhe vlerësimeve teknike.

Punimet në rrugët "Bashkimi Kombëtar", "Shaban Polluzha" dhe "Jakup Ceraja" iu nënshtruan verifikimit në terren për të siguruar përputhshmërinë me standardet.

Analiza e infrastrukturës në pjesën veriore përfshiu vlerësimin e rrjetit, stacioneve të pompimit dhe rezervuarëve, si dhe definimin e objekteve që kërkojnë masa mbrojtëse (rrethim).

Verifikimi i gjatësive për rrethimin e rezervuarëve kontribuoi në planifikimin e ndërhyrjeve të nevojshme për sigurinë e aseteve.

2. Planifikimi teknik dhe përgatitja e projekteve

Paramasa dhe parallogaria për rregullatorë dhe valvula të ajrimit u përgatitën në funksion të përmirësimit të operimit të rrjetit.

Në bashkëpunim me KRU-Prishtina, u zhvilluan paramasa bazike për projektet në pjesën veriore.

Hartimi i arsyeshmërisë për projektet investive 2026–2028 krijoi bazë për planifikim afatmesëm.

Rishikimi i Planit të Biznesit për sektorin teknik reflektoi prioritetet dhe nevojat aktuale të sistemit.

3. Menaxhimi i projekteve dhe kontratave

U menaxhuan dhe u mbikëqyrën kontratat për:

Furnizimin me ujë për lagjen e Mazhiqët

Furnizimin me pjesë fazonike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit

Kontrata për furnizimin dhe instalimin e klorinatorit me sistem automatik në Raknicë u drejtua në përputhje me kërkesat teknike.

Faza e dytë e furnizimit me materiale nga kontrata për pjesë fazonike avancoi kapacitetet për mirëmbajtje të rrjetit.

Kontroli i sasisë dhe cilësisë së materialeve (valvula, rregullatorë, pjesë fazonike) garantoj standardin e nevojshëm për përdorim në sistem.

4. Digjitalizimi dhe menaxhimi i të dhënave

Procesi i digjitalizimit të stacioneve të pompimit u avancua përmes koordinimit të vazhdueshëm me ekipin teknik.

Përgatitja dhe dorëzimi i dataset-it digjital për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit përmbushi kërkesat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Identifikimi i parcelave të aseteve në pjesën veriore kontribuoi në formalizimin dhe menaxhimin më të mirë të pronës.

5. Bashkëpunimi institucional dhe projektet zhvillimore

U zhvilluan takime me komisionet për:

- Planin e Sigurisë së Ujit
- Pranimin e ujëmatësve të vegjël
- U realizuan takime dhe koordinime me projektin WRIPS.
- U zhvilluan takime të shumta me projektin KIWER, duke përfshirë:

- Qëndrueshmërinë klimatike për ujërat
- Humbjet e ujit dhe efikasitetin e energjisë
- Definimin e zonave për DMA
- Operacionalizimin e veprimeve për HU dhe EE
- Orientimin në terren të ekspertëve të jashtëm
- U zhvilluan takime me Ministrinë e Mjedisit për procedurat dhe vazhdimin e lejeve ujore, përfshirë llogaritjen e shfrytëzimit të ujit për ITU-të.
- U realizuan takime me delegacione dhe partnerë ndërkombëtarë, përfshirë GIZ dhe SWS (Structures, Water & Survey).

6. Aktivitetet operative në terren

Definimi i kyçjeve në lagjen Iliridë u realizua përmes analizës së drejtpërdrejtë në terren.

Monitorimi i punimeve në lagjen Begaj (Vushtrri) siguroi kontroll mbi realizimin e projekteve. Vizitat dhe takimet teknike me KRU-Prishtina mundësuan zhvillimin e projekteve për pjesën veriore dhe koordinimin ndërinstytucional.

7. Raportimi dhe proceset rregullative

Kompletimi i raporteve teknike dhe raportimi në nivel menaxherial siguruan transparencë dhe ndjekje të progresit.

Kontributi në procesin e tarifave të ARRU u realizua përmes përgatitjes së të dhënave teknike sipas kërkesave zyrtare.

8. Trajnimet dhe zhvillimi profesional, kontribuan në ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Pjesëmarrje në trajnimet për:

- Planin e Biznesit
- Menaxhimin e bazuar në rezultate
- Teknologjitë e sistemeve të ujërave të zeza (modulet përkatëse)
- Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, përfshirë:
- "Water Europe" – Danube Regional Water (Danimarkë)
- Konferencën Ballkanike për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit

Këto aktivitete kanë qenë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të kompanisë dhe përmbushjen e qëllimeve të parashikuara në planin operativ dhe strategjik të vitit 2025.

2.7 SHËRBIMI KOMERCIAL

Realizimi i objektivave strategjike

Gjatë vitit 2025, sektori komercial ka realizuar në masë të konsiderueshme objektivat strategjike të përcaktuara, duke u fokusuar në rritjen e efikasitetit operativ, përmirësimin e menaxhimit të konsumatorëve dhe forcimin e disiplinës financiare. Përmes një qasjeje të integruar ndërmjet sektorëve të shitjes, kontrollës dhe shërbimit ndaj konsumatorëve, është arritur një përmirësim i dukshëm në performancën e përgjithshme, duke reflektuar rezultate konkrete në faturim, inkasim dhe menaxhim të borxheve.

Realizimi i objektivave është mbështetur në forcimin e kontroleve në terren dhe identifikimin sistematik të konsumatorëve ilegalë dhe të paidentifikuar, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e humbjeve komerciale dhe rritjen e bazës së konsumatorëve të rregullt. Paralelisht, përmes përmirësimit të proceseve të faturimit dhe zbatimit të rregulloreve në fuqi, është siguruar një rritje e qëndrueshme e të hyrave dhe një regjistrim më i saktë i konsumit të ujit.

Një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave strategjike ka luajtur edhe përmirësimi i procedurave të inkasimit dhe ofrimi i mundësive fleksibile për shlyerjen e borxheve, përmes kontratave të reja dhe ri-programimit të detyrimeve. Këto masa, së bashku me rritjen e transparencës dhe intensifikimin e komunikimit me konsumatorët, kanë ndikuar në rritjen e besimit ndaj kompanisë dhe në përmirësimin e përvojës së përgjithshme të konsumatorit.

Strategjia e qasjes ndaj konsumatorit

Strategjia e qasjes ndaj konsumatorit është ndërtuar mbi një model të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore dhe zhvillimit të marrëdhënieve afatgjata me konsumatorët. Kjo qasje synon jo vetëm përmbushjen e kërkesave aktuale, por edhe parashikimin e nevojave të tyre, përmes një angazhimi proaktiv dhe komunikimi të vazhdueshëm. Në këtë drejtim, institucioni ka synuar të identifikojë kërkesat dhe pritjet e konsumatorëve përpara se ato të shndërrohen në ankesa, duke siguruar informim të rregullt dhe të qartë për çdo ndryshim apo zhvillim që ndikon në shërbimet e ofruara.

Një element i rëndësishëm i kësaj strategjie është qasja ndaj konsumatorëve, ku trajtimi bëhet në përputhje me kategoritë dhe profilin e tyre, duke mundësuar ofrimin e zgjidhjeve fleksibile për pagesa dhe menaxhimin e obligimeve financiare. Kjo ka ndikuar në rritjen e kënaqësisë së konsumatorëve dhe në përmirësimin e marrëdhënieve me ta.

Gjithashtu, strategjia bazohet fuqishëm në parimet e transparencës dhe ndërtimit të besimit. Qasja e hapur ndaj ankesave dhe kërkesave ka kontribuar në rritjen e besueshmërisë dhe përmirësimin e imazhit institucional.

Paralelisht, janë ndërmarrë masa për përmirësimin e përvojës së konsumatorit, duke reduktuar kohën e pritjes dhe duke rritur nivelin e profesionalizmit të stafit, çka ka ndikuar në ofrimin e një shërbimi më efikas dhe më cilësor.

2.7.1 Aktivitetet kryesore

Gkësaj periudhe është punuar edhe në përmirësimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, përmes mobilizimit dhe organizimit më efikas të zyrave të shërbimit komercial, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, të shpejtë dhe të qasshëm për konsumatorët. Gjithashtu, i është kushtuar vëmendje e veçantë komunikimit me publikun përmes aktiviteteve të marketingut, publikimit të njoftimeve informuese dhe ndërgjegjësuese, si dhe përmes rritjes së transparencës në informimin e konsumatorëve lidhur me shërbimet dhe obligimet e tyre ndaj kompanisë. Pikat kryesore të aktiviteteve të realizuara janë:

2.7.2 Identifikimi dhe trajtimi i konsumatorëve ilegalë dhe të paidentifikuar:

- U realizuan kontrole intensive për identifikimin e konsumatorëve ilegalë, ku ata që ishin kyçur pa lejen e kompanisë janë identifikuar dhe dërguar për gjykim.
- U identifikuan gjithashtu konsumatorët që përdornin ujëmatës të dëmtuar apo që kishin dyfishuar regjistrimet e konsumatorëve për të njëjtën pronë.
- Aktivitetet përfshinë gjithashtu verifikimin e kushteve të shtëpive të braktisura ose të rrënuara dhe korrigjimin e lidhjeve të paligjshme të ujit, duke siguruar që çdo lidhje të jetë e rregullt dhe në përputhje me rregulloret.

Janë realizuar kontrole sistematike në terren, të cilat kanë rezultuar në **identifikimin dhe trajtimin e rasteve të lidhjeve ilegale**. Konsumatorët e identifikuar janë proceduar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kontribuar drejtpërdrejt në uljen e humbjeve komerciale të ujit dhe në përmirësimin e menaxhimit të rrjetit.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve është realizuar edhe **verifikimi i gjendjes së ujëmatësve të dëmtuar, identifikimi i regjistrimeve të dyfishta të konsumatorëve për të njëjtën pronë, si dhe kontrolli i objekteve të braktisura**, me qëllim korrigjimin e evidencave dhe eliminimin e parregullsive në sistem.

Performanca e këtyre aktiviteteve është matur përmes **indikatorëve kyç**, si përqindja e rasteve ilegale të identifikuara ndaj totalit të kontrolluar, numri i lidhjeve ilegale të eliminuara, si dhe niveli i reduktimit të humbjeve komerciale të ujit (%), duke reflektuar efektivitetin e masave të ndërmarra.

2.7.3 Ngritja e performancës dhe rritja e faturimit:

- Sektori i Shitjes dhe kontrolla realizuan një rritje të faturimit duke zbatuar vendimet e Autoritetit Rregullator për Ujin (ARRU), duke u fokusuar veçanërisht tek konsumatorët që keqpërdorin furnizimin me ujë.
- Faturimi ka pësuar një rritje të ndjeshme, duke u rritur me **16.01%** në vlerë dhe **5.56%** në sasi, duke reflektuar një përmirësim të menaxhimit dhe regjistrimit të konsumit të ujit.

2.7.4 Përmirësimi i procedurave të inkasimit dhe rritja e numrit të pagesave:

- Të dhënat e mbledhura tregojnë një rritje të inkasimit me **19.84%** krahasuar me vitin 2024, ndërsa numri i pagesave është rritur me **9.48%**, si rrjedhojë e një kontrolli më të rreptë dhe menaxhimit më të mirë të borxheve të konsumatorëve.

2.7.5 Zhvillimi i kontratave të shërbimit dhe ri-programimit të borxheve:

- Gjatë vitit 2025 janë nënshkruar **7,564** kontrata shërbimi dhe **1,718** kontrata ri-programimi për një vlerë totale prej **1,133,127.12 €**, duke treguar një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e menaxhimit të borxheve dhe mundësitë e pagesës për konsumatorët.

2.7.6 Përmirësimi i kushteve të shërbimit në zyrat komerciale

- Për të ofruar një shërbim më cilësor për konsumatorët, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e kushteve të punës dhe organizimit në zyrat e shërbimit komercial. Mobilizimi i stafit dhe organizimi më efikas i proceseve të punës kanë ndikuar në ofrimin e shërbimeve më të shpejta dhe më profesionale për konsumatorët.

2.6.7 Informimi i konsumatorëve

- Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar rëndësi e veçantë komunikimit me publikun përmes aktiviteteve të marketingut dhe publikimit të njoftimeve informuese. Përmes këtyre aktiviteteve është synuar rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për rëndësinë e përdorimit racional të ujit, për obligimet

ndaj kompanisë dhe për informimin e tyre lidhur me shërbimet dhe aktivitetet e ndërmarra nga kompania. Përmes këtyre aktiviteteve, shërbimi komercial ka arritur të rrisë performancën dhe efikasitetin, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të burimeve dhe duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për konsumatorët.

Tabela 22. Shpërndarja e konsumatorëve ilegalë sipas zonave

Njësia Operative	Konsumatorë Ilegal
Mitrovicë	148
Vushtrri	247
Skenderaj	8
Gjithsej:	403

Përveç aktiviteteve konkrete, të dhënat e përmbledhura në tabelën e performancës paraqesin një pasqyrë të qartë të përmirësimeve dhe sfidave të vitit 2025 në krahasim me vitin 2024:

Tabela 23. Indikatorët e performancës

Përshkrimi	2025	2024	Ndryshimi në %
Inkasimi (€)	5,545,374	4,627,153	19.84%
Faturimi m ³	13,842,125	13,112,648	5.56%
Faturimi (€)	6,497,956	5,600,601	16.01%
Numri i pagesave	224,850	205,370	9.48%
Nr. i Konsumatorëve	56,535	52,353	7.98%

Kjo tabelë tregon një përmirësim të vazhdueshëm në sektorin e shërbimit komercial, ku aktivitetet për rritjen e faturimit dhe menaxhimin e borxheve kanë dhënë rezultatet e pritura, ndërkohë që janë identifikuar disa sfida në fushën e inkasimit, të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme për të përmirësuar performancën e përgjithshme.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, periudha 2024/2025 karakterizohet nga një përmirësim i ndjeshëm në pothuajse të gjithë indikatorët kyç të performancës. Inkasimi është rritur nga 4,627,153 € në 5,545,374 €, që paraqet një rritje rreth 19–20%.

Fakti që inkasimi është rritur me normë më të lartë se rritja e volumit të konsumit tregon se nuk kemi vetëm rritje teknike, por përmirësim real në menaxhimin komercial.

Faturimi në vlerë është rritur nga 5,600,601 € në 6,497,956 €, me rritje prej rreth 16%. Kjo ka kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e të hyrave të kompanisë.

Në përfundim, aktivitetet e shërbimit komercial kanë pasur një ndikim të dukshëm dhe pozitiv në përmirësimin e performancës dhe efikasitetit të faturimit. Të gjithë indikatorët kryesorë financiarë dhe operacionalë paraqesin trend pozitiv, ku inkasimi është rritur me ritëm më të shpejtë se faturimi në sasi, faturimi në € ka shënuar rritje të konsiderueshme, baza e konsumatorëve është zgjeruar dhe numri i pagesave është rritur ndjeshëm.

Këto zhvillime tregojnë përmirësim të menaxhimit komercial, rritje të efikasitetit operacional, forcim të disiplinës financiare dhe stabilizim gradual të performancës së inkasimit. Pavarësisht sfidave ekzistuese, kompania ka vendosur trajtimin e konsumatorëve ilegalë dhe menaxhimin e borxheve si një prioritet të vazhdueshëm. Këto përpjekje synojnë jo vetëm të mbrojnë të ardhurat aktuale, por edhe të rrisin efikasitetin operativ, të forcojnë disiplinën financiare dhe të sigurojnë qëndrueshmëri në të ardhmen. Duke fokusuar burimet dhe strategjitë në këto fusha, kompania përpiqet të krijojë një sistem të qëndrueshëm menaxhimi të riskut dhe të nxisë besimin e konsumatorëve dhe partnerëve.

2.8 INFORMIMI I KONSUMATORËVE

Gjatë vitit 2025, Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun ka vazhduar me përkushtim dhe profesionalizëm realizimin e aktiviteteve të saj, duke siguruar komunikim të vazhdueshëm, transparent dhe të përgjegjshëm me qytetarët, konsumatorët dhe opinionin publik. Përkushtimi i departamentit ka qenë i orientuar drejt informimit të saktë dhe në kohë, forcimit të besimit institucional dhe mbështetjes së objektivave strategjike të KRU "Mitrovica" Sh.A.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar komunikimit gjatë zhvillimeve të rëndësishme institucionale, situatave sfiduese operative dhe proceseve me interes publik, duke kontribuar në ngritjen e imazhit dhe besueshmërisë së kompanisë.

2.8.1 Informimi

Informimi i rregullt dhe transparent i qytetarëve ka qenë një ndër prioritetet kryesore të KRU "Mitrovica" Sh.A. gjatë vitit 2025. Përmes njoftimeve të vazhdueshme, publiku është informuar mbi punimet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërprerjet e planifikuara dhe emergjente të furnizimit me ujë,

aktivitetet e ekipeve teknike dhe inspektuese në terren, si dhe mbi obligimet dhe mundësitë lehtësuese të pagesës për konsumatorët.

Komunikimi i hapur dhe i koordinuar ka ndihmuar në përmirësimin e bashkëpunimit me qytetarët dhe institucionet relevante, duke mundësuar adresimin më efikas të nevojave dhe shqetësimeve të tyre.

2.8.2 *Komunikimi online dhe platforma sociale*

Gjatë vitit 2025, komunikimi digjital ka qenë një kanal kyç për informimin dhe ndërveprimin me publikun. Burimet kryesore të informimit kanë përfshirë:

- Uebfaqja zyrtare e kompanisë, e cila është përditësuar rregullisht me dokumente zyrtare, konkurse, njoftime, raporte dhe informacione relevante për publikun, në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies.
- Facebook, si platforma kryesore për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët, përmes së cilës janë publikuar njoftime operative, aktivitete institucionale, fushata ndërgjegjësuere dhe komunikime në kohë reale.
- E-maili zyrtar, përmes të cilit janë pranuar dhe trajtuar kërkesa, ankesa dhe shqetësime të qytetarëve në afate optimale, në bashkëpunim me njësitë përkatëse të kompanisë.

2.8.3 *Promovimi dhe aktivitetet ndërgjegjësuere*

Gjatë vitit 2025, KRU "Mitrovica" Sh.A. ka realizuar aktivitete të ndryshme promovuese dhe ndërgjegjësuere me fokus informimin publik dhe edukimin mjedisor. Ndër aktivitetet kryesore veçohen:

- Fushata të vazhdueshme për përdorimin racional të ujit të pijshëm, veçanërisht gjatë periudhave me konsum të lartë.
- Shënimi i 22 Marsit – Ditës Botërore të Ujit, përmes aktiviteteve edukative në institucionet arsimore dhe vizitave studimore në Impiantet e Trajtimit të Ujit dhe Ujërave të Ndotura.
- Organizimi i aktiviteteve edukative në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, me fokus edukimin e fëmijëve dhe të rinjve për ruajtjen e mjedisit.
- Promovimi i aktiviteteve institucionale dhe bashkëpunimeve ndër-institucionale përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

2.8.4 *Transparenca dhe komunikimi në procesin e rekrutimit të stafit*

Një pjesë e rëndësishme e komunikimit gjatë vitit 2025 ka qenë transparenca në proceset e punësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore. Zyra ka siguruar publikimin e konkurseve për vendet e lira të punës në të dy gjuhët zyrtare, duke garantuar qasje të barabartë dhe procese të hapura rekrutimi.

Në këtë kuadër janë realizuar edhe komunikime publike dhe video-mesazhe institucionale, përfshirë prononcime të Kryeshefit Ekzekutiv dhe shpërndarjen e mesazheve mbështetëse institucionale, me qëllim inkurajimin e pjesëmarrjes së gjerë të qytetarëve në konkurset e hapura.

2.8.5 *Raportimi*

Raportimi i rregullt dhe transparent ka qenë një komponent thelbësor i funksionimit të KRU "Mitrovica" Sh.A. gjatë vitit 2025. Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun ka kontribuar në përgatitjen dhe publikimin e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore, në koordinim me sektorët administrativ, financiar, komercial dhe teknik.

Të gjitha raportet janë përgatitur në përputhje me standardet e raportimit dhe janë analizuar e miratuar nga Bordi i Drejtorëve, duke siguruar përputhje me objektivat strategjike dhe llogaridhënie institucionale.

2.9 **PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE**

Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN)

Nevoja për Investim,

Mungesa e sistemit të kanalizimit në rajon përbën një rrezik të lartë për shëndetin publik dhe ndot në mënyrë të drejtpërdrejtë ujin nëntokësor. Investimi në ndërtimin e një Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUZ) është thelbësor për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

ITUN Mitrovicë: Kapaciteti 123,000 banore

Zona e Shërbimit, Mitrovicë – Vushtrri: Do të ndërtohen rreth 50km kolektorë në bregun e lumenjve Sitnica në dy anet e lumit (nga Vushtrria deri te Impianti), Ibri nga Zupqi, Lushta nga Broboniqi, Trepca nga Trepca dhe Fshatrave që gravitojnë rreth Lumenjve të sipër përmendur do të përfshihen në kolektor.

2.9.1 **Përmbledhje e aktiviteteve gjatë vitit 2025**

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar aktivitete kyçe për projektin e ndërtimit të ITUN dhe zhvillimin e rrjetit të kanalizimit në Mitrovicë. Projekti financohet nga BERZH dhe BEI përmes Qeverisë së Kosovës dhe zbatohet nga KRU "Mitrovica" Sh.A. në bashkëpunim me komunat dhe institucionet relevante.

2.9.2 Analiza e lokacioneve dhe studimi i alternativave

Janë analizuar katër lokacione alternative për impiantin, pa evidentim të problemeve kritike. BERZH miratoi vazhdimin e studimit, ndërsa u realizuan analiza teknike, gjeologjike dhe laboratorike. Konsulenti dorëzoi raportin fillestar dhe draftin e studimit të alternativave.

2.9.3 Marrëveshjet institucionale dhe financiare

Janë nënshkruar marrëveshje kyçe ndërmjet komunave, BERZH-it dhe KRU Mitrovica, si dhe marrëveshje financiare, përfshirë grantin WBIF (5 milion €) dhe grantin FOPIP (337,500 €). Kredia për projektin u bë efektive në prill 2025.

2.9.4 Përzgjedhja e lokacionit të impiantit

Pas analizave, lokacioni M1 u përzgjedh si opsioni i preferuar dhe u konfirmua zyrtarisht nga Komuna e Mitrovicës, duke mundur vazhdimin e projektit.

2.9.5 Hapat e ardhshëm të projektit

Faza e radhës përfshin përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe të tenderit, procedurat e shpronësimit dhe hapjen e tenderit për ndërtim sipas standardeve FIDIC (Libri i Verdhë).

2.9.6 Zgjerimi i projektit – Faza II

Projekti do të zgjerohet për të përfshirë edhe Mitrovicën e Veriut dhe Zveçanin, me qëllim krijimin e një sistemi të integruar rajonal. BERZH do të përditësojë studimin e fizibilitetit.

2.9.7 Programi FOPIP – Permisimi i Performances Operative – Teknike në KRU Mitrovica

Bazuar në ToR, FOPIP-i përbëhet nga këto komponentë kryesorë:

Identifikimi i fushave prioritare për përmirësim: cilësia e shërbimeve, reduktimi i humbjeve (NRW), rritja e arkëtimeve, rritja e efikasitetit të kostove.

Përgatitja e një programi të detajuar për përmirësimin financiar dhe operacional: Ristrukturimi organizativ, Sistemet e MIS dhe IFRS, Performanca e stafit dhe racionalizimi, Politika e tarifave dhe analiza sociale, Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, Strategjia për NRW, Marrëdhëniet me konsumatorët.

Zhvillimi i Planit Afatgjatë të Biznesit (20 vjet)

Zhvillimi i Corporate Development Programme (CDP)

Procesi i vlerësimit të ofertave është në zhvillim dhe pritet nënshkrimi i marrëveshjes në fillim të muajit prill.

2.10 RAPORTI SHËRBIMIT ADMINISTRATIV & BURIMEVE Njerezore

2.10.1 Përmbledhje

Procesi i rekrutimit të stafit, i nisur në muajin maj të vitit 2025, është zhvilluar në koordinim të ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht me Ministrinë e Ekonomisë dhe Zyrën e BE-së në Kosovë, si dhe me mbështetje profesionale nga GIZ Kosova.

Në kuadër të këtij procesi janë realizuar aktivitete të rëndësishme për rekrutimin e stafit në NJO në veri, duke përfshirë angazhimin e ekspertëve të jashtëm ligjorë, ekspertëve të komunikimit dhe profileve të tjera përkatëse.

Procesi ka vijuar me:

- rishikimin e rregulloreve të brendshme,
- organizimin e fushatave informuese për rekrutimin,
- trajnimin e stafit mbi procedurat e rekrutimit,
- zhvillimin e testeve, intervistave dhe vlerësimeve të kandidatëve.
- angazhimin e përkthyesve të licencuar,

Ky angazhim ka pasur për qëllim sigurimin e një procesi rekrutimi transparent, profesional dhe në përputhje me standardet përkatëse.

Në këtë fazë, objektivi i parë strategjik është ndërtimi i një strukture funksionale njerëzore dhe organizative, e aftë për të marrë përgjegjësi të plota në terren dhe për të integruar njësitë veriore në sistemin operativ të KRUM-it. Për këtë qëllim, janë identifikuar pozitat prioritare operative, teknike dhe administrative, fillimisht janë përzgjedhur pozitat menaxheriale, përfshirë Menaxherët e Njërive Operative, si dhe Menaxheri për Përpunimin e Ujit në Zubin Potok. Paralelisht, janë rishikuar procedurat e rekrutimit dhe sistematizimit, si dhe është siguruar mbështetje ligjore për harmonizimin e kërkesave me mundësitë procedurale.

Objektivi i dytë në këtë fazë është ngritja e kapaciteteve profesionale dhe integrimi i stafit në procedurat dhe sistemet ekzistuese të KRUM-it.

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Administratës ka luajtur një rol kyç në sigurimin e funksionimit të rregullt organizativ, koordinimit ndërmjet departamenteve dhe mbështetjes administrative të organeve drejtuese të kompanisë. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Bordin e Drejtorëve, menaxhmentin dhe udhëheqësit e sektorëve ka qenë thelbësor për realizimin e objektivave strategjike dhe operacionale të kompanisë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Departamenti i Administratës ka zhvilluar këto aktivitete kryesore:

- Organizimin dhe administrimin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, duke siguruar përgatitjen e dokumentacionit përkatës dhe respektimin e procedurave ligjore dhe të brendshme.
- Hartimin dhe arkivimin e procesverbaleve, përgatitjen e agjendave dhe shpërndarjen në kohë të raporteve dhe dokumenteve zyrtare, me qëllim garantimin e transparencës dhe komunikimit efektiv brenda kompanisë.
- Përgatitjen dhe administrimin e kontratave të punës, vendimeve dhe akteve administrative, si dhe menaxhimin e të dhënave të personelit dhe përditësimin e tyre në sistemet përkatëse.
- Organizimin dhe zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozita të reja pune, duke siguruar transparencë, barazi dhe respektim të kriterëve profesionale.
- Monitorimin dhe administrimin e të dhënave lidhur me pushimet vjetore dhe mjekësore të punonjësve, duke garantuar saktësi dhe përditësim të vazhdueshëm të evidencave.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, Departamenti i Administratës ka kontribuar në rritjen e efikasitetit operacional, forcimin e disiplinës administrative dhe përmirësimin e komunikimit institucional në të gjitha nivelet e organizatës.

2.10.2 Burimet njerëzore

Gjatë vitit 2025, kompania ka regjistruar një numër të konsiderueshëm lëvizjesh të punonjësve, përfshirë daljen në pension, ndërprerjen e kontratave të punës, skadimin e kontratave, si dhe dorëheqjet. Këto ndryshime kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën e burimeve njerëzore dhe janë menaxhuar me kujdes për të siguruar vazhdimësinë dhe efektivitetin e punës.

Të dhënat e këtyre lëvizjeve janë pasqyruar më poshtë në tabelën e detajuar, e cila përfshin informacionet e nevojshme për secilën lëvizje, duke përfshirë arsyet e largimit dhe çdo informacion shtesë që mund të jetë i dobishëm për menaxhimin e burimeve njerëzore në të ardhmen. Për më tepër, është punuar intensivisht për të optimizuar proceset e rekrutimit dhe mbajtjes së punonjësve. Ky proces ka përfshirë implementimin e masave që sigurojnë një ambient pune të shëndetshëm, përmirësimin e kushteve për zhvillimin profesional të stafit, si dhe një komunikim të hapur dhe efikas me të gjithë anëtarët e kompanisë. Këto hapa janë ndërmarrë me qëllim për të rritur motivimin dhe angazhimin e punonjësve, duke siguruar që çdo individ të kontribuonte në mënyrë efektive në realizimin e qëllimeve të kompanisë.

Tabela 24: Lëvizja e punonjësve gjatë vitit 2025

Përshkrimi	Meshkuj	Femra	Total
Numri i të punësuarve të rinjë gjatë vitit 2025	13	0	13
Numri i të punësuarve që u është ndërprerë kontrata e punë gjatë vitit 2025 (përmes procedurave disiplinore)	2	0	2
Numri i të punësuarve që u është ndërprerë kontrata për shkak të dorëheqjes	4	1	5
Numri i të punësuarve që i është shkëputur kontrata me rastin e pensionimit apo vdekjes	10	0	10

Nga ana tjetër po paraqesim strukturën profesionale të stafit të strukturuar në bazë të përkatësisë nacionale dhe nivelit të përgatitjes shkollore.

Tabela 25: Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve

Përgatitja profesionale														
Struktura	Master		Baçelor		E mesme/e lartë		Shkolla Fillore		Pakualifikuar		Gjithsej:		Totali :	
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F		M/F
Nacionale														
Shqiptar	16	6	23	13	160	11	12	1	8		219	31	250	
Serb														
Malazez														
Turq														
Boshnjak							1				1		1	
Ashkali									1		1		1	
Gjithësej:	16	6	23	13	160	11	13	1	9		221	31	252	

Tabela 26: Statistika Profesionale dhe Gjinore e KRUM – 2025 Sipas Njësive

Përgatitjet Profesionale të Punonjësve													
2025	Master		Baçelor		E mesme/e lartë		Shkolla Fillore		Pakualifikuar		Gjithsej:		Totali
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
Njësit													
Mitrovicë	13	5	14	11	90	8	4		4		125	24	149
Vushtrri	2		6	2	45	2	7	1	2		62	5	67
Skenderaj	1	1	3		25	1	2		3		34	2	36
Gjithsej:	16	6	23	13	160	11	13	1	9		221	31	252

2.110.3 2.9.3 Zyra ligjore

Gjatë vitit 2025, është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykata, Prokurori të Republikës së Kosovës, si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përbaruesit privat për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.

Tabela 27. Të dhënat mbi lëndët përbarimore

Përshkrimi	Pagesë borxhi në kompani	Riprogramim i borxhit	Borxhi i falur/si borxhi i vjetër	Pagese uji tëk përbaruesi	Kthimi i shpazimeve nga përbaruesi	Lidrim nga TVSH 8%	Pagesat nga kontratat
Janar	1,765	10,043	11,792	7,630	2,001	813	634
Shkurt	2,015	17,097	16,224	3,162	602	1,202	2,276
Mars	2,811	40,387	23,573	3,774	935	1,746	5,034
Prill	3,087	69,507	27,902	3,681	786	2,067	6,986
Maj	2,391	23,160	19,636	19,130	1,378	1,455	1,723
Qershor	1,336	23,510	12,492	5,807	689	853	5,163
Korrik	6,835	71,069	28,335	2,019	579	2,098	12,009
Gusht	-	-	-	4,212	553	-	-
Shtator	-	-	-	4,982	603	-	-
Tetor	-	-	-	2,778	357	-	-
Nentor	-	-	-	1,860	321	-	-
Dhjetor	-	-	-	2,938	390	-	-
Totali	20,240	254,773	139,954	61,975	9,196	10,234	33,825

Tabela 28. Të dhënat mbi lëndët sipas muajve

Muaji	Propozime	Përgjigje Prapësim	Ekzekutime /Lëndëve të Perfunduara	Kontrata/ Marrëveshje	Kallezime Penale
Janar	0	35	95	46	0
Shkurt	1	4	11	56	08
Mars	0	4	36	44	06
Prill	167	10	17	39	13
Maj	0	33	26	74	15
Qershor	0	3	16	90	21
Korrik	0	7	18	94	00
Gusht	0	24	14	108	0
Shtator	0	21	19	67	05
Tetor	0	12	19	55	08

2.111 AKTIVITETET E PROKURIMIT

Prokurimi publik është funksion kyç për menaxhimin e fondeve publike dhe sigurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve për funksionim efikas të institucioneve. Ai zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme, trajtimit të barabartë dhe përdorimit racional të buxhetit.

Aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar sipas planifikimit dhe nevojave të KUR "Mitrovica" Sh.A., përmes platformës elektronike e-prokurimi, duke siguruar procedura transparente dhe efikase.

Raporti Vjetor i Prokurimit paraqet përmbledhjen e aktiviteteve gjatë vitit, përfshirë numrin dhe llojin e procedurave, vlerën e kontratave dhe çmimet e paguara. Ky raport ofron një pasqyrë të qartë të performancës dhe nivelit të zbatimit të LPP-së, si dhe shërben si instrument për transparencë dhe llogaridhënie institucionale.

Tabela 29. Aktivitetet e prokurimit

Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuare e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Çmimi total i paguar për kontratën	Emri dhe adresa e kompanisë fituese
Furnizim me pajisje për faturim mobil	4,500.00	3,070.00	3,070.00	Pattern SH.P.K.
Mirëmbajtja dhe përkrahja në sistemin Financiar (ERP) dhe atë të Faturimit (Billing).	7,500.00	7,434.00	5,575.50	ASEE SH.P.K.
Furnizim me pjesë fazonike për rrjetin e ujit	60,000.00	47,876.00	42,791.30	Xërxa Hidro Group SH.P.K.
Furnizimi me ujë të pijës për lagjen "Mazhiqët" në Vushtrri.	25,000.00	23,745.38	23,745.38	N.N.P. "HYSNIA"
Sigurimi shëndetësor i stafit të KUR Mitrovica Sh.A	75,000.00	65,826.00	47,713.50	Kompania E Sigurimeve Të Përgjithshme Siguria
Furnizim dhe montim me GPS dhe instalim i aplikacionit	7,000.00	6,399.14	1,847.88	PROFESSIONAL ALARM L.L.C.
Furnizim me rregullator presioni, valvula ajërimi dhe pjesë fazonike	70,000.00	67,488.20		Xërxa Hidro Group SH.P.K.
Furnizim me pajisje për asgjësimin e letrave- Shreder Ri tender II	1,500.00	1,249.50	1,249.50	MEDIATECH & PRINT SH.P.K.
Furnizim me Klorur Ferrik	45,000.00	40,827.60	24,496.53	N.T.SH." BIZUN "
Shërbime për mirëmbajtjen e automjeteve të KUR "Mitrovica" Sh.A Ri tender II	25,000.00	24,009.25	15,673.00	Erdogan Pirqi B.I.

Furnizim me derivate të naftës për automjetet e KUR "Mitrovica" Sh.A	35,000.00	35,000.00	20,223.44	Petrol Company - SH.P.K.
Furnizimi dhe montimi i sistemit të sigurimit nëpër stacione të pompimit dhe rezervuar (vendosja e rrethojave për këto objekte)	9,900.00	7,766.00		MEGRANT ING SH.P.K.
Furnizim me PC, Laptop dhe Monitora	6,000.00	4,937.00	4,937.00	Pattern SH.P.K.
Furnizim me rroba të punës për punëtorët e mirembajtjes	6,000.00	4,779.00	4,779.00	Agron Commerce SH.P.K.
Furnizimi dhe montimi me Invertar	4,000.00	2,370.00	2,370.00	4ING SH.P.K.
Furnizim dhe montim i klorinatorit me sistem të automatikës	4,000.00	3,205.77	3,205.77	PROKIM SH.P.K.
Mirembajtja e sistemit të faturimit mobil offline	3,000.00	2,973.60	736.32	Tretek SH.P.K.
Zhvillimi i sistemit eKomerç (eKRUM) dhe mirembajtja e tij.	30,000.00	13,791.84	-	Tretek SH.P.K.
Furnizim me pjesë fazonike për rrjetin e ujit	25,000.00	21,594.10	17,618.70	Xërxa Hidro Group SH.P.K.
Furnizim me printera multifunksional dhe tonera	6,000.00	5,139.00	5,139.00	RIKON SH.P.K.
Furnizim me rolle fiskale për faturim mobil PDA.	4,500.00	3,000.00	1,829.10	" INFINITT " SH.P.K.
Ofrimi i Shërbimeve Juridike	5,000.00	4,560.00	760	RPHS LAW L.L.C.
Furnizimi me vajra dhe antifriz për automjete të KRU " Mitrovica" Sh.A	3,000.00	1,474.00	1,474.00	" Balkan Petro " SH.P.K.
Furnizim me goma për automjetet e KUR Mitrovica Sh.A	7,000.00	6,030.00	-	Goma Pro SH.P.K.
Furnizim me Eskavator	105,000.00	93,550.00	-	Grup i OE BauMachine L.L.C.; Enver Balliu B.I.
Sigurimi i Automjeteve të KRU-Mitrovica Sh.A	990	918.04	918.04	KS EUROSIG SH.A.
Sigurimi i Automjeteve të KRU-Mitrovica Sh.A Ri tenderi II	9,500.00	6,529.16	-	KS EUROSIG SH.A.
Furnizim me reagensa dhe enë për laborator Ri tender II	9,800.00	9,503.70	-	Flamur Isufi B.I.
Furnizim dhe montim me Klima Inverter 24BTU	900	630	-	AS Tech SH.P.K.

2.1.12 PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEM

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" operon si një ndërmarrje që është llogaridhënëse tek Bordi i Drejtorëve, duke vepruar në përputhje me principet e qeverisjes korporative. Bordi i Drejtorëve, përfshirë Drejtorët Jo-ekzekutiv dhe Drejtorët/Zyrtarët Ekzekutiv, ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike për periudhën afatgjatë (deri në vitin 2027) për të siguruar zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme të kompanisë. Këto qëllime përfshijnë:

- Zgjerimin e zonës së shërbimit, me fokus të veçantë në komunat veriore;
- Mbulimin e plotë të konsumatorëve me ujëmatës, një objektiv i caktuar edhe nga ARRU;
- Sigurimin e vetë qëndrueshmërisë financiare të kompanisë;
- Furnizimin e rregullt dhe të pandërprerë me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët;
- Promovimin e marrëdhënieve të mira me konsumatorët dhe publikun;
- Krijimin e një ambienti të favorshëm pune për të gjithë punonjësit;
- Përbushjen e obligimeve që dalin nga deklarata e nivelit të shërbimeve;
- Rritjen e investimeve kapitale.

Për realizimin e këtyre qëllimeve strategjike afatgjata, kompania ka planifikuar shfrytëzimin e resurseve të saj, si dhe mbështetje nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorë aktualë dhe potencialë. Objektivat përfundimtare që pritet të arrihen deri në vitin 2027 përfshijnë:

- Zvogëlimin e shkallës së ujit të pa faturuar në 48%;
- Pajisjen e konsumatorëve me ujëmatës në shkallën prej 100%;
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 88%;
- Ngritjen e normës së punës në 1.20;
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.39.

Këto objektiva janë përcaktuar me qëllim të rritjes së efikasitetit operativ, menaxhimit të burimeve dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica".

2.1.12.1 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë Plan, kompania ka përdorur analizën SWOT dhe metodologjinë e katër faktorëve: përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Këta faktorë

lidhen ngushtë me rritjen e organizatës, produktet, shërbimet dhe objektivat e biznesit, si dhe konkurrencën në treg. Dy nga këta faktorë janë të brendshëm – përparësitë dhe dobësitë – që lidhen me ndikimin e vetë kompanisë në suksesin e saj. Ndërsa dy faktorët e tjerë – mundësitë dhe rreziqet – janë të jashtëm dhe varen nga ambienti i jashtëm i kompanisë. Për të arritur rezultatet e duhura, KRUM do të përpiqet të minimizojë dobësitë dhe rreziqet, ndërkohë që do të maksimizojë përparësitë dhe mundësitë.

22.12.2 Përparësitë:

- Përvoja shumëvjeçare në sektorin e ujësjellësit;
- Infrastruktura e zhvilluar e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Treg i sigurt me konsumatorë të besueshëm dhe shitje të garantuar;
- Mbështetje nga partnerët, përfshirë: Qeverinë, Komunat, SHUKOS, ARRU, BE, CDI dhe donatorë të tjerë;
- Mungesa e konkurrencës në sektorin operues;
- Kapacitete të mjaftueshme prodhuese, si impiantet në Shipol dhe Balinc.

22.12.3 Dobësitë:

- Pajisje të vjetra dhe jo të përshtatshme me metodat bashkëkohore;
- Moshë e shtyrë e fuqisë punëtore;
- Konsumi i ujit në veri dhe mos pagesa e tij;
- Humbje të mëdha teknike dhe komerciale;
- Gjendje e vështirë ekonomike dhe nivel i lartë i rasteve sociale në rajonin e Mitrovicës;
- Sistemi Informativ Menaxhues (MIS) i paoptimalizuar;
- Borxhet e trashëguara nga klientët.

22.12.4 Mundësitë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të konsumatorëve;
- Zhvillimi i shërbimeve të reja dhe lehtësuese për konsumatorët;
- Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit;
- Bashkëpunimi me kompani të sektorit të ujit, si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, dhe shkëmbimi i përvojave;
- Bazë e mirë ligjore për procedimin e lëndëve të ndryshme në gjykata apo përmes përmbauesve privatë;
- Infrastruktura ligjore nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU);

- Pjesëmarrje në konferenca vendore dhe rajonale përmes Shoqatës së Ujësjetësve të Kosovës (SHUKOS);
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit.

2.12.5 Rreziqet:

- Kriza ekonomike e rajonit si pasojë e papunësisë;
- Ngritja e tensioneve sociale dhe/apo politike;
- Fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.);
- Shfaqja e një pandemie të re;
- Trendi i ikjes së fuqisë punëtore

Pasqyra e pozitës financiare

më 31 dhjetor 2025

	2025	2024
	€	€
PASURITË		
Pasuritë afatshkurtra		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	346,870	106,481
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	27,304,520	26,745,978
Stoqet	342,745	257,238
Gjithsej pasuritë afatshkurtra	<u>27,994,135</u>	<u>27,109,696</u>
Pasuritë afatgjata		
Prona, pajisjet dhe impiantet	18,945,471	21,362,383
Prona investuese		
Investimet në vijim	90,676	90,676
Gjithsej pasuritë afatgjata	<u>19,036,147</u>	<u>21,453,059</u>
Gjithsej pasuritë	<u>47,030,282</u>	<u>48,562,755</u>
DETYRIMET DHE EKUITETI		
DETYRIMET		
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	1,637,347	1,234,374
Tatimet e pagueshme	3,514,493	3,554,258
Pagat e pagueshme	-	454
Kredia pjesa afatshkurter	25,572	24,086
Te Tjera	9,031	46,650
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	<u>5,186,444</u>	<u>4,859,822</u>
Detyrimet afatgjata		
Detyrimet e tjera afatgjata	15,309,925	16,615,486
Kredia pjesaafatgjate	29,486	55,057
Gjithsej detyrimet afatgjata	<u>15,339,410</u>	<u>16,670,543</u>

Gjithsej detyrimet	20,525,854	21,530,366
EKUITETI		
Kapitali aksionar	26,490,000	26,490,000
Fitimet e mbajtura	14,428	542,390
Rezervat tjera (Terheqjet)		
Gjithsej ekuiteti	26,504,428	27,032,390
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	47,030,282	48,562,755

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025**

	2025 €	2024 €
Të hyrat	5,978,426	5,192,940
Kostoja e shitjes	644,564	678,111
Fitimi / (humbja) bruto	5,333,863	4,514,828
Të ardhurat tjera	1,425,308	1,368,801
Shpenzimet e shpërndarjes	2,658,281	2,628,253
Shpenzimet administrative	4,621,525	3,742,957
Shpenzimet e tjera		
Fitimi / (humbja) operativ	(520,635)	(487,582)
Shpenzimet financiare	7,328	10,730
Të ardhurat financiare		
Fitimi / (humbja) para tatimit	(527,962)	(498,311)
Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(527,962)	(498,311)

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:

Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave

financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit

Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit

-	-
-	-
(527,962)	(498,311)

Pasqyra e e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezerv at e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2024	26,490,000	1,040,700	0	27,530,700
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(498,311)		(498,311)
Diferencat nga përkthimet valutore				-
Dividendat-Terheqjet e pronarit				-
Deponimet e kapitalit shtesë				-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	26,490,000	542,389	-	27,032,389
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(527,962)		(527,962)
Diferencat nga përkthimet valutore				-
Dividendat				-
Deponimet e kapitalit shtesë				-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	26,490,000	14,427	-	26,504,427

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

Pershkrimi	2025 €	2024 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(527,962)	(498,311)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	2,509,052	2,496,895
Shpenzimet financiare	7,328	10,730
Kthim i provizionit, te hyrat tjera	(42,000)	
Provizioni i stoqeve	18,000	
Shpenzimet e tatimit në fitim		
	1,964,417	2,009,314
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(558,542)	(589,071)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(103,507)	(5,728)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	367,137	(75,916)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	(1,350,035)	(1,335,846)
	(1,644,946)	(2,006,561)
Tatimi në fitim i paguar		
Interesi i paguar	(7,328)	(10,730)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	312,144	(10,730)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(47,669)	(168,486)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(47,669.00)	(168,486)

Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë		
Dividendat e paguara-Terheqjet e pronarit		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		100,000
Ripagimi i kredive dhe huave	(24,085)	(20,862)
Ndryshimi ne vitet e kaluara		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	(24,085.00)	79,138
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	240,390	(97,325)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	106,481	203,806
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	346,870	106,481